

Shkretëria E Ringjalljes

Një Seri Mësimesh Nga Sejjid Hasan Nasrullahu

13.8.2021

Media e Lire

www.mediaelire.net

**Një Seri Mësimesh Nga
Sejjid Hasan Nasrullahu
Shkretëria E Ringjalljes**

**Një Seri Mësimesh Nga
Sejjid Hasan Nasrullahu
Shkretëria E Ringjalljes
Besimi Dhe Vepra E Mirë Ndriçojnë Udhën**

**Me Emrin E Allahut
Gjithëmëshirshmit
Mëshirëplotit**

Pasqyra E Përmbajtjes:

Hyrje

Parathënie

Përmendja E Vdekjes Dhe E Botës Tjetër

E Vërteta E Vdekjes Dhe Pyetjet E Menjëhershme

Diçka Për Shpirtin

Nevojat E Diturisë Për Botën Tjetër

Dëshmia E Jetës Pas Vdekjes

Kreu I Parë

Varri Dhe Berzahu (Jeta e Varrit)

Banesat E Para Të Jetës Tjetër

Ndërhyrja E Qenies Së Jetës Së Varrit

Përpunimi I Etapave Të Jetës Së Varrit

Ndarja E Njerëzve Në Berzah

Kush Janë Këta Njerëz?

Një Vështrim I Shpejtë I Gjendjes Së Dëshmorëve Në Berzah

Përmendja E Klasës Së Tretë

Morali Për Vetën Dhe Besimi

Kreu i Dytë

Fundi I Mbërritjes

Ngjarjet E Ringjalljes Së Fundit Dhe Tmerret E Saj

Hyrje: Përdorimi I Vërtetë Dhe Metaforik I Gjuhës

Gjuha E Vërtetë Dhe Metaforike Në Kur'anin E Shenjtë

Tregues Të Ringjalljes Së Fundit

Gjendja E Qenieve Të Gjalla Në Ditën E Ringjalljes

Si Do Të Shkaktojë Allahu Vdekjen E Tyre?

Skena Kozmike E Ditës Së Ringjalljes

Çfarë Do Të Ndodhë Në Shkallën e Kozmosit?

Çfarë Kuptojmë Ne Nga Këto Skena Kuranore?

Paraqitja Bashkëkohore Në Provë Kuranore

Rikthimi Në Jetë Dhe Ringjallja E Të Vdekurve

Qëndrimi Përpara Allahut Për Gjykim

Kush Do Të Shpërblehet Në Atë Ditë?

Vështrimi Dhe Kapërcimi I Siratit

Shkurtimisht Mbi Qëllimin E Këtij Kërkimi

Beteja E Kerbelasë Dhe Udhëtimi Në Botën Tjetër

Çfarë U Shkoi Në Mendje Këtyre Njerëzve Siç Vijnë

Kjo Është Historia E Kerbelasë Në Thellësi Dhe Në Të Vërtetë

Hyrje

Ne të tërë e kuptojmë se do të largohemi nga kjo botë e përkohshme, nuk ka rëndësi nëse qëndrimi ynë në tështë i gjatë ose i shkurtër. Duke u mbështetur në doktrinën tonë islame, si shumë fe të tjera, ne me të vërtetë do të përballemi me ditën tonë të gjykimit dhe sipas gjasave me jetën e përjetshme. Qenia dhe jeta të cilat ne i shpenzojmë në këtë botë kalimtare nuk janë gjë tjetër vetëm se sprova, me të cilat ne do të shpërblehemi me bekimin e përjetshëm, ose do të ndëshkohemi me mallkimin e përhershëm. Kjo botë e përkohshme nuk është gjë tjetër vetëm se një udhë dhe fushë për të mbjellur veprat tona të cilat do të korren në botën e përtejme. Vdekja vetëm shënon fundin e veprave, fillimin e gjykimit dhe urës në përjetësi së cilës një njeri kalon nga dhimja e përkohshme deri në pavdekshmëri. Kjo është e vërteta më e madhe më e rëndë dhe më e hidhur. Ky është çasti i fundit të cilit askush nuk mund t'i shmanget. Përkujtimi i vazhdueshëm i vdekjes, i Ditës së Gjykimit dhe i Ditës së Ringjalljes rivendos thelbin në jetën e njeriut në vetëdije edhe njëherë duke parandaluar një njeri nga shmangia nga ose harrimi i këtij fundi të pashmangshëm. Në mësimet që ia shpërndau në përkujtimin e përvjetorit të Ashurasë më 1437 m.i. / 2015 (Nata e shtatë dhe e nëntë e muajit Muharrem 1435 m.i. ose 20 dhe 22 tetor 2015). Sejjid Hasan Nasrullahu (Allahu e ruajtë) foli për vdekjen dhe (ditën e) shkretëtirës së ringjalljes dhe etapat që një njeri do t'i kalojë përmes. Duke marrë parasysh domehënien e këtyre dy mësimëve ne e gjuqum të nevojshme që t'i përpilojmë ato në këtë libër duke ua paraqitur ato lexuesve, duke uruar që Allahu t'iu dhurojë ju dhe ne një fund të mirë dhe shpërblime të mëdha.

Parathënie

Përmendja E Vdekjes Dhe E Botës Tjetër

Allahu i Madhëruar dhe i Lartësuar në Librin e Tij të lavdishëm thotë: *“A është ai i cili lutet në orët e natës duke u përulur (në gjunjë) dhe duke qëndruar (në këmbë) i shqetësuar nga bota tjetër dhe duke pritur mëshirën e Zotit të tij? Thuaj: “A janë ata të barabartë ata të cilët dinë me ata të cilët nuk dinë?” Vetëm ata të cilët janë të zotët e mendjes marrin këshillë” (Sure Zumer, Ajeti 9).*

Në vijim do të shqyrtohen çështjet e vdekjes, përjetësia dhe të tëra pyetjet që kanë të bëjnë me çështje të tilla si Dita e Ringjalljes dhe jeta e përtejme ndër të tjera. Ky hulumtim do të hedhë dritë mbi detyrimet dhe përgjegjësitë tona si njerëz në këtë botë të zakonshme kundrejt botës tjetër. Në të vërtetë kjo çështje ka rëndësi të madhe, sepse kuptimi i vdekjes dhe bota tjetër përcakton bazën për shumë gjëra dhe veprime të jetës në këtë botë. Për shembull është çështja e Kerbelasë; të tëra ngjarjet që ndodhën në Kerbela dhe pasojat e saj rrjedhin kryesisht nga kjo çështje - çështja e botës së zakonshme dhe botës së ardhshme - dhe si do të perceptohet dhe shtjellohet bota tjetër, qoftë në fushën e Imam Husejnit (p.m.t.) ose në atë të armikut.

E Vërteta E Vdekjes Dhe Pyetjet E Menjëhershme

Para se të hetojmë këtë çështje, vëmë re se gjendet një e vërtetë e pranuar nga të tërë njerëzit, që nga Ademi (p.m.t.) deri në ditët e sotme dhe do të mbetet e pranuar nga të tërë deri në Ditën e Ringjalljes e cila është e vërteta e vdekjes. Të tërë do të vdesin në mënyrë të pashmangshme dhe nuk ka vend për këmbëngulje në lidhje me këtë çështje. Nëse do të bredhim të tërë botën, nuk do të gjejmë një qenie njerëzore të shëndoshë që pretendon të jetë e pavdekshme dhe e përjetshme sepse të tërë njerëzit e pranojnë se do të vdesin. Sërish për sa

i përket kësaj bindjeje, nuk ka dallim midis një besimtari në qenien e Allahut ose një jobesimtari, një monoteisti apo politeisti, adhuresi të idhujve ose gurëve, ose një që nuk adhuron ndonjë zot apo diçka tjetër. Ata të tërë e pranojnë të vërtetën e vdekjes. Gjatë tërë historisë dhe derisa të vijë çasti (vendimtar), njerëzit vazhdojnë të pajtohen me këtë të vërtetë- e vërteta e vdekjes me të cilën Allahu i ka pushtuar shërbëtorët e tij **“dhe Ai i pushtoi shërbëtorët e Tij nëpërmjet vdekjes dhe vdekshmërisë”** (**“Duatu’s-Sabahi” (Lutja e Mëngjesit) / Lutja e Mëngjesit e Imam Ali Ibn Ebi Talibit**). Prandaj ne përballemi me një të vërtetë të pashmangshme dhe të padiskutueshme. Nuk ka rëndësi se çfarë besimi dhe shkalle mendimi ka, se cili është sfondi doktrinor i dikujt, ose nëse një njeri është adhures i një feje apo jo njeriu është i detyruar të vdesë. Kjo e vërtetë sigurisht që lind një çështje kryesore dhe qendrore çfarë vjen pas vdekjes? Kjo është një pyetje logjike, e natyrshme dhe e vlefshme.

Çfarë vjen pas vdekjes? Çfarë vjen pas vdekjes sonë si njerëz? Ndërsa vazhdon kjo jetë, atëherë vallë ku kanë shkuar ata të cilët kanë vdekur nga vëllezërit dhe të afërmit tanë? Çfarë i pret ata? Gjithashtu çfarë ndodh pasi kjo botë do të ketë mbaruar? Çfarë vjen pas përfundimit të këtij universi? I tërë njerëzimi ashtu si të tërë dijetarët pajtohen se universi po shkon drejt fundit natyror të tij, rrënimin të tij natyror, kështu që çfarë vjen pas kësaj?

Ajo që të tërë ne e respektojmë dhe dimë me anë të mprehtësisë dhe ndërgjegjes - larg nga ndërlikimet filozofike dhe apologjetike që janë shumë të gjera për një çështje që duhet përfshirë këtu - është se kur një njeri vdes dhe njerëzit vdesin çdo ditë dhe i shohim ato si kufoma përpara nesh, shpirti ose shpirti niset nga trupi i atij njeriu; një trup mund të ketë organe të shëndosha, që nuk vuajnë nga ndonjë sëmundje problem mjekësor ose çrregullim. Vdekja vjen tek ky trup, merr shpirtin dhe e bën atë një kufomë të palëvizshme.

Pastaj sipas besimeve fetare të atij njeriu, shumica e njerëzve zakonisht i japin lamtumirën asaj kufomekur është ende gjatëxhenazesë. Ata e varrosin në një varr nën një copë toke të vogël dhe hedhin dhë në të tërë varrin. Pasi kujtesa e saj të zbehet dhe nuk përmendet më, çfarë ndodh me këtë kufomë në këtë varr, çfarë do të ndodhë me këtë njeri të vdekur?

Ne jemi gjithashtu të vetëdijshëm se ky trup pas një periudhe kohore, do të shpërbëhet përfundimisht. Krimbat dhe larvat do të ushqehen me të derisa ai të zvogëlohet në njëskelet. Pas një periudhe më të gjatë kohe, asgjë nuk do të mbetet më nga ai, përveç kockave të kalbura (P.sh. kockat e kalbura në lidhje me fjalët e Allahut të Plotfuqishëm në ajetin vijues që rrëfen pohimin e atyre që mohojnë veprën e ringjalljes: **“Ata do të thonë: “A po kthehemi në gjendjen tonë të mëparshme? Çfarë do të bëhet kur ne kemi qenë kocka të kalbura?!”** (Sure Naziat, Ajetet 10-11).

Kur të kalojë më shumë kohë ai do të asgjësohet plotësisht nga dhéu. Familja e njeriut të vdekur do të duhet të largohet dhe të marrë ngushëllimet e njerëzve. Ata do të përmendin të afërmin e tyre të vdekur për ditë, osejavë dhe më tej do të rifillojnë jetën e tyre të zakonshme. Përndryshe, jeta nuk do të kishte vazhduar më. Kjo është e njohur për të tërë.

Diçka Për Shpirtin?

Shpirti që ka lënë këtë trup, i cili është kthyer në një kufomë të palëvizshme, a do të vdesë gjithashtu? A do të qëndrojë i gjallë, i ndërgjegjshëm, i vetëdijshëm për ata të cilët e rrethojnë dhe të ndiejë dhimbje, hidhërim apo gëzim? Çfarë do të bëhet me këtë shpirt, të cilit mund t'i drejtohemi si “vetja”? Ku do të banojë? Ku do të vendoset? Cili do të jetë fati i taj? Këto pyetje do të shpalosin pyetje të tjera si: A ka jetë (botë) tjetër pas vdekjes? Çfarë është kjo

botë? Si është? Cilat janë kushtet, ligjet, parimet dhe rregullat e saj? A është e ngjashme me botën tonë apo e ndryshme? A ka lidhje midis dy botëve? A do të ketë gjykime në atë botë? Dhe nëse duhet të gjykohe mi, a do të jetë ky gjykim sipas veprimeve tona në këtë botë apo diçka tjetër? Ka shumë pyetje por ato janë të zakonshme dhe të vlefshme.

Këto dhe pyetje të tjera ia vlej në që të meditohe n dhe të kërkojnë një mendim të thellë, si dhe një hulumtim të plotë, serioz dhe autentik. Kjo është si pasojë se ata janë të lidhur me fatin tonë dhe fatin e të dashurve tanë. Kur dikush e do dikë - një nënë, at, bashkëshort, pasardhës, motër, vëlla dhe të afërm - pa dyshim do të merret me fatin e tyre. Gjithashtu dikush dëshiron që të mësojë për fatin e tij si dhe për të tjerët.

Nevojat E Diturisë Për Botën Tjetër

Ne kemi përmendur se të mësuarit rreth kushteve dhe aktualiteteve të botës tjetër - jetës pas vdekjes - është e nevojshme për lidhjen e saj me fatin dhe fundin e një njeriu. Kështu kjo kërkesë nuk është vetëm për të fituar njohuri të pastër, por për të kërkuar diçka që lidhet me ne, fatin tonë, jetën tonë në atë botë, lumturinë tonë të përhershme ose pafundësinë, sigurinë dhe mirëqenien tonë dhe paqe. Prandaj, kjo është një kërkim i fatit, i cili kërkon punë, masa paraprake, plane dhe gatishmëri, sepse ne kemi një udhëtim të gjatë para nesh dhe një jetë të gjatë.

Ajo e cila është e çuditshme - dhe një problem që hasin të tërë besimtarët dhe jobesimtarët - është se edhe pse jemi të vetëdijshëm se nuk do të jetojmë në këtë botë të zakonshme por vetëm për disa vite, Allahu e di ndoshta edhe për disa minuta, e marrim si të mirëqenë se do të jetojmë për një periudhë të gjatë kohore. Kështu ne e arsimojmë veten, marrim diplomë, punojmë, ndërtojmë shtëpi, pajisemi me mobilje, martohemi, kemi fëmijë, shfaqim pushtet mbi të tjerët, kërkojmë pozita më të larta dhe autoritet për të mbrojtur veten dhe për të përfutur siguri për veten dhe familjet, kujdesemi për shëndetin tonë dhe atë të të tjerëve, përpiqemi të shtimë në dorë mirëqenie dhe kështu me radhë. Me fjalë të tjera, ne bëjmë përpjekjet tona më të mira për të përmirësuar jetën tonë të shkurtër këtu, e megjithatë nuk e shohim veten duke punuar për jetën tjetër, e cila do të zgjasë për miliona vjet, ose më mirë është një jetë tjetër! A nuk mendojmë për këtë? A nuk përgatitemi për të? A nuk ndërtojmë banesa atje? A nuk mbjellim kopshte atje? A nuk përgatitemi dhe përftoj më siguri, mirëqenie, kërkesa të lartë, bollëk, dinjitet, nder, shkallë dhe shoqëri të lartë atje? A nuk punojmë për shmangien e vuajtjes së zjarrit të xhehennemit të cilin asnjë njeri nuk mund të përfytyrojë - këtë pasojë të pashmangshme ndaj së cilës nuk mund të shpëtohet?

Me të vërtetë është e çuditshme sjellja jonë si në vete dhe në palë. Ajo bie në kundërshtim me arsyetimin dhe logjikën si dhe as nuk përputhet me këndvështrimin e interesit dhe përfutimit vetjak. Le të themi se dikush doli dhe ju tha se një tërmet i fortë do të godasë vendbanimin tuaj brenda një viti apo dy dhe do të shkatërrojë gjithçka çfarë do të bënit? Çdo njeri do të fillonte të mendonte se si ta shiste shtëpinë e tij, t'i përfundonte të tëra punët e tij në atë zonë dhe të blinte një shtëpi tjetër. Ka të ngjarë që ai të largohet pa marrë parasysh veten me ndonjë gjë tjetër përveç mbijetimit të rrezikut të afërt, duke marrë parasysh se ishte një parashikim shkencor që mund ose nuk mund të ndodhë. Një shembull tjetër mund të jetë një njeri të cilit i thuhet se është një armik, i cili po qëndron i fshehur rrugës përmes së cilës ai po kalon ose një fushë të minuar përgjatë rrugës dhe se ai duhet ta marrë këtë rrugë dhe asnjë tjetër, a nuk e nxit kjo dukuri që të bëjë përgatitjet e nevojshme, të mësojë si të çmontojë minat dhe si të ballafaqohet me armikun e fshehur, në mënyrë që të arrijë i sigurtë në

vendmbërritjen e tij? Pra nëse një qenie njerëzore sillet kështu në këtë botë, pse nuk merret me jetën e tij të përjetshme, me fatin, burimin e sigurisë së tij, sigurinë, mirëqenien dhe lumturinë dhe atë që e pret në botën tjetër në të njëjtën mënyrë? Gjatë tërë jetës, planifikojmë, studiojmë, përgatisim projekte, punojmë ditë e natë për të siguruar ushqim, strehim, siguri dhe mirëqenie, t'i mbajmë larg armiqtë dhe të garantojmë një jetë të mirë shoqërore, por çfarë kemi përgatitur për jetën tjetër? Si e kemi pajisur veten? Si dhe çfarë kemi bërë për këtë qëllim? Kjo është pyetja kryesore!

Në të vërtetë mundësia e një jete dhe një bote tjetër pas vdekjes mjafton për t'i dhënë shtysë një njeriu që të ndërmarë veprime dhe të përgatitet për atë jetë. Prandaj edhe nëse nuk është e sigurtë për qenien e jetës dhe botës tjetër, të menduarit se ka një mundësi është mëse e mjaftueshme - logjikisht dhe duke u mbështetur mbi arsyes - për ta bërë një njeri të vëmendshëm dhe për të marrë masat paraprake. Përgatitja e vetes për këtë mundësi është një domosdoshmëri sepse nuk ka fare shans për veprat pas vdekjes.

Sa i përket besimtarëve të cilët besojnë tek Allahu, i Lavdëruar dhe i Lartësuar qoftë Ai, në emrat dhe tiparet e Tij, fuqia e Tij e cila nuk ka kufi, përsosmëria dhe bujaria e Tij, krenaria, madhështia dhe hakmarrja e Tij, si dhe drejtësia e të Plotfuqishmit, cilët janë ato të cilat iu drejtohem këtu në veçanti, ata janë ata të cilët duhet të përgatiten për atë botë dhe nuk duhet të jenë kurrë të pakujdesshëm.

Dëshmia E Jetës Pas Vdekjes

Ne besojmë në jetën pas vdekjes, qenien e jetës tjetër dhe se do të ketë gjykim që çon në shpërblim ose dënim për çdo vepër që njeriu ka kryer, si dhe në xhennetin dhe xhehennemin. (Gjenden një numër i madh ajetesh në Kur'anin e Famëlartë dhe përcjellje të rrëfyera nga Ehli Bejti (p.q.m.t.) të cilat përmendin botën tjetër, duke përfshirë shpërblimet, dënimet, xhennetin, xhehennemin dhe ditën e ringjalljes dhe gjykimin në atë masë sa që besimtari nuk ka vend për dyshim në sheriatin (ligjin hyjnor) të të dërguarit Muhammed (p.q.m.t.) për pashmangshmërinë e ndodhjes së tyre. Disa nga ajetet të cilat përmenden në Kur'anin Fisnik janë si më poshtë: *“Kini kujdes ditën kur asnjë shpirt nuk do të zëvendësojë një tjetër, as ndonjë ndërmjetësim nuk do të pranohet nga ai, as ndonjë shpërblim nuk do të merret nga ai dhe as nuk do të ndihmohen”*. (Sure Bekare, Ajeti 48) / *Nuk ka zot tjetër përveç Tij me siguri Ai do t'iu mbledhë në Ditën e Ringjalljes në të cilën nuk ka dyshim dhe kush është më i sinqertë në të folur sesa Allahu?”* (Sure Nisa, Ajeti 87) / *“Me të vërtetë, Ora (e Ringjalljes) është e detyruar që të vijë: Unë do ta fsheh që çdo shpirt të shpërblehet për përpyekjen e tij”*. (Sure Ta Ha, Ajeti 15) / *“Ky është vendbanimi i botës tjetër të cilin Ne do t'u japim atyre që nuk dëshirojnë të sundojnë në tokë dhe as të shkaktojnë trazira dhe përfundimi do të jetë në dobi të atyre të cilët veprojnë mirë”*. (Sure Kasas, Ajeti 83) dhe shumë ajete të tjera. Ndërsa për sa i përket përcjelljeve të Ehli Bejtit thuhet se i dërguari i Allahut (p.q.m.t.) ka thënë: *“Me të vërtetë vdekja duhet të jetë e domosdoshme. Vdekja vjen me atë që përfshin; ajo vjen me lehtësim, lehtësim dhe kthim të bekuar në një xhennet të lartë (duke patur për qëllim) banorët e vendbanimit të përjetshëm, përpyekja e të cilit ishte ndaj tij dhe dëshira për të dhe vdekja vjen me atë që përfshin, me mjerimin, keqardhjen dhe me kthimin e dështuar në zjarrin përvëlues të xhehennemit (duke patur për qëllim) banorët e vendbanimit të mashtrimit”*. (Imam Kulejini, “Usulu Minel-Kafi” (Mënyra e Mjaftuesit), Libri “Xhena'iz” (Xhenazetë), Kreu “Neuader” (Gjërat e Rralla), Hadithi Nr: 27, ai (Ebu Bekri) i tha gjithashtu Ebu Dherit: *“O Ebu Dher gjykoje veten para se të gjykohesh, kjo do të jetë më e lehtë për vlerësimin tënd nesër (në Ditën e Gjykimin); peshoje*

veten para se të peshohesh dhe përgatitu për shqyrtimin përfundimtar, ditën kur do të shqyrtohesh, asnjë e fshehtë nuk do të fshihet nga Allahu”.(Imam Kulejni, “Mizanu’l-Hikmeti” (Peshorja e Urtësisë), vëll. 2, Hadithi Nr: 3841), në mesin e shumë përcjelljeve të tjera të rrëfyera në librat e haditheve.

Unë nuk do të gërmoj në një hulumtim të gjatë dëshmues për të provuar këto pyetje, sepse ajo e cila kërkohet këtu është thjeshtë të vërtetojmë dëshmitë mbi të cilat do të mbështetemi. Megjithatë nuk ka asnjë të keqe në përmendjen e disa pikëpamjeve të dëshmisë në përmbajtjen e lartpërmendur.

Pikë së pari njëra nga dëshmitë e jetës pas vdekjes është dëshmia se të tërë të dërguarit e Allahut (p.q.m.t.), të cilët u dërguan gjatë të tërë historisë së njerëzimit - numri i të cilëve sipas disa përcjelljeve arrin në 124.000-kanë folur për jetën e përtejme. (Shumica e përcjelljeve pajtohen me këtë numër. Vepra me titull: “*Hisal*” (Përftimi) rrëfen se kur Ebu Dheri e pyeti të dërguarin e Allahut (p.q.m.t.) për numrin e të dërguarve ky i fundit (p.q.m.t.) u përgjigj: “*Ata ishin njëqind e njëzet e katër mijë të dërguar*”. (Imam Kulejni, “Mizanu’l-Hikmeti” (Peshorja e Urtësisë), vëll. 10, Hadithi Nr: 19495) Në një përcjellje tjetër në veprën më titull: “*Eamal*” (Veprat) i dërguari i Allahut (p.q.m.t.) ka pohuar: “*Allahu i Plotfuqishëm krijoi njëqind e njëzet e katër mijë të dërguar dhe unë jam më i nderuari para Allahut. Megjithatë unë nuk krenohem për këtë*”. (“*Eamalu’s-Sadiki*” (Veprat e më të Singertit), vëll. 41, Hadithi Nr: 11) ndër të tjera 124.000 të dërguar (p.m.t.), të njohur nga populli i tyre për dinjitetin, besueshmërinë, drejtësinë dhe ndershmërinë e tyre, e pëcollën këtë të dhënë nga Allahu i Lartësuar është Ai. Tani them se është themeluar në sheriatin (ligjet hyjnore) islame se të tërë të dërguarit (p.m.t.)- duke filluar që nga Ademi (p.m.t.) dhe deri tek i dërguari i Islamit Muhammedi (p.q.m.t.) - i kanë bërë thirrje popujve të tyre që të besonin tek Allahu, Njëshmëria e Tij dhe Dita e Gjykimit.

Kur’ani Famëlartë flet për këtë në ajete të shumëfishta. Kur’ani Fisnik rrëfen kështu për të dërguarin Nuh (p.m.t.): “*(Me të vërtetë) Ne e dërguam Nuhun tek populli i tij. Ai tha: “O populli im, adhuroni Allahun! Nuk keni zot tjetër përveç Tij. Në të vërtetë unë kam frikë për ju dënimin e një dite të tmerrshme*”. (Sure Araf, Ajeti 59); I dërguari Ibrahim (p.m.t.) thotë: “*Dhe kur Ibrahim tha: “O Zoti im, bëj këtë një qytet të sigurtë dhe siguroje popullin e tij me fruta të tilla si ata të cilët besojnë tek Allahu dhe Dita e Fundit*”. (Sure Bekare, Ajeti 126); I dërguari Jusuf (p.m.t.) ka thënë: “*(O Zoti im!) Ti më ke dhënë një pjesë në mbretëri dhe më ke mësuar interpretimin e ëndrrave. Krijuesi i qiejve dhe i tokës! Ju jeni kujdestari im në këtë botë dhe në botën tjetër! Bëjeni vdekjen time me nënshtrim dhe bashkomëni me të drejtët*”. (Surja Jusuf, Ajeti 101) gjithashtu Kur’ani i Shenjtë përmend dhe të dërguarin Musa (p.m.t.) i cili ka thënë: “*Dhe dhurona të mira për ne në këtë botë dhe në botën tjetër, sepse me të vërtetë ne jemi kthyer tek Ti*”. (Sure Araf, Ajeti 156), duke përfshirë edhe shumë ajete të Kur’anit Famëlartë të cilat flasin për të dërguarit të cilët ishin dërguar para Islamit, të cilat tregojnë se të tërë të dërguarit e mëparshëm besonin tek bota tjetër dhe u bënë thirrje njerëzve të besonin në të.

Për më tepër të tërë librat qiellorë autori i të cilave është Allahu dhe i Cili ua ka përcjellur të dërguarve gjithashtu flasin për atë botë dhe jetë. Kur’ani Fisnik, libri i shenjtë i përjetshëm dhe i fundit të cilin e vërtetojnë arsyetimi dhe hadithet në mënyrë të padiskutueshme, përfshin gati një mijë ajete të cilat bëjnë fjalë mbi çështjen e botës tjetër dhe ngjarjeve të cilat do të ndodhin në atë botë, pas vdekjes, para dhe pas ringjalljes dhe gjithçka e cila do të ndodhë më pas në lidhje me xhennetin, xhehennemin, të tërë përjetësinë, etj. Madje gjenden dhe krerë

(sure) në Kur'anin Famëlartë, titujt e të cilave i drejtohen botës tjetër të tilla si: **“Xhathijje”** (Gjunjzimi Nga Frika e Kijametit), **“Uakia”** (Ngjarja, Kijameti), **“Hashr”** (Ringjallja), **“Mumtehene”** (E Sprovuara), **“Hakka”** (E Vërteta), **“Kijame”** (Kijameti), **“Tekuir”** (Mbështjellja), **“Infitar”** (Çarja), **“Gashijje”** (Ngjarja Shkatërruese), **“Zelzele (Tërmeti)** dhe **“Karia”** (Krisma, Kijameti). Gjenden dhe disa sure, përmbajtja e të cilave i drejtohet botës dhe jetës tjetër ndonëse titujt e tyre nuk e pasqyrojnë atë ashtu siç është sureja **“Insan”** (Njeriu).

Për më tepër ajo e cila sigurisht vërteton këtë çështje është se është e domosdoshme drejtësia hyjnore. Besimi ynë tek drejtësia e Allahut bën thirrje për qenien e jetës pas vdekjes. Meqenëse shumica e besimtarëve dhe njerëzve të drejtë në këtë botë të zakonshme, nga Ademi (p.m.t.) dhe deri tek Dita e Ringjalljes, ende nuk kishin marrë shpërblime për veprat e tyre të mira; pasi ata vriten, bien dëshmorë, vuajnë dhimbje dhe përballen me vështirësitë e kësaj jete ndërsa të tjerët jetojnë më të lumtur. Kështu që duhet të ketë një botë tjetër duke qenë se drejtësia hyjnore kërkon që këta njerëz - 124.000 të dërguar, qindra mijëra besimtarë, njerëz të virtytshëm dhe dëshmorë gjatë tërë historisë - do të shpërblehen për veprat e tyre të mira. Duhet të ketë një botë dhe jetë tjetër ku ata do të marrin shpërblimin për xhihadin e tyre, plagët, dhimbjet, vuajtjet, durimin, vetëpërmbajtjen, varfërinë dhe përvojat të cilat ata përjetuan në këtë botë me sinqeritet dhe përkushtim.

Nga ana tjetër, shtypësit, dhunuesit, kriminelët, despotët, vrasësit dhe të pabesët, të cilët e kanë mbushur tokën me padrejtësi, degjenerim, shkatërrim dhe tirani, si firauni (faraoni) dhe Nemrudi dhe të tërë ata të cilët i kanë paraprirë dhe i kanë ndjekur ata dhe gjenden një numër shumë i madh shtypës në këtë tokë - nuk u përballën me ndëshkim në këtë botë. Drejtësia hyjnore kërkon që të ketë një botë tjetër ku do të gjykohen, do të paguhen dhe do të dënohen për krimet e tyre, degjenerimin, shkatërrimin dhe shtypjen e kryer kundër shërbëtorëve dhe krijimeve të Allahut. Prandaj ajo botë duhet të jetë dhe ajo ditë duhet të vijë. (Për sa i përket firaunit, sqarojmë se ai ishte një tiran gjatë kohës së të dërguarit Musa (p.m.t.). Ai ishte kryelartë. Ai shtypte të bijtë e Izraelit të njohur si beni Israil (fëmijët e Izraelit) dhe e shpalli veten si një zot. Ai përmendet në Kur'anin e Shenjtë në të shumtën e rasteve siç është ajeti: **“Me të vërtetë firauni është bërë kryelartë në tokë dhe popullin e tyre e ka ndarë në palë-palë duke shfarosur një palë nga ai, duke u therrur djemtë e tyre dhe duke ua lënë të gjalla gratë e tyre. Më të vërtetë ai ishte një shkatërrues i madh”**. (Sure Kasas, Ajeti: 4); **“A nuk iu ka ardhur ngjarja e Musait kur Zoti i tij e thirri atë në luginën e shenjtë Tuua duke i thënë: “Shko tek firauni sepse me të vërtetë ai është bërë kryelartë” dhe thuaj: “A nuk do të pastrohesh?”; “Unë do t’iu drejtoj tek Zoti yt që të keni frikë nga Ai!”; “Atëherë ai i tregoi atij shenjen më të madhe, por ai e mohoi dhe nuk iu bind. Pastaj ai u kthye duke ecur me shpejtësi, duke mbledhur dhe duke e shpallur duke thënë: “Unë jam zoti juaj më i lartë!”; “Kështu Allahu e ndëshkoi atë me dënimin e kësaj bote dhe të botës tjetër”**. (Sure Naziat, Ajetet 15-25); **“Ne i shpëtuan beni israilët (bijtë e Izraelit) nga dënimi poshtërues i firaunit. Më të vërtetë ai ishte një tiran në mesin e shkatërruesve”**. (Sure Duhan, Ajetet 30-31) si dhe në shumë ajete të tjera. / Ndërsa për sa i përket Nemrudit bëjmë të ditur se ai ishte tiran gjatë kohës së të dërguarit Ibrahim (p.m.t.). Ai ishte një nga mbretërit e Babilonisë të cilit Allahu i dha atij një mbretëri, por dhe ai u bë kryelartë dhe shkatërrues në tokësi dhe e shpalli veten si një zot. Allahu i drejtohet atij në Kur'anin Famëlartë në ajetin vijues: **“A nuk iu ka ardhur ngjarja e atij njeriu (Nemrudit), i cili debatoi me Ibrahimin për Allahun, vetëm si pasojë se Allahu i kishte dhënë atij mbretëri? Kur Ibrahim tha: Zoti im është Ai i Cili jep jetë dhe sjell vdekje!” Ai u përgjigj: “Edhe unë jap jetë dhe sjell vdekje!” Ibrahim**

shtoi: “Zoti im e sjell diellin nga lindja sille pra ti atë nga perëndimi!” Atëherë ai i cili nuk besoi mbeti i hutuar. Allahu nuk e udhëzon popullin dhunues”. (Sure Bekare, Ajeti 258)

Kreu I Parë

Varri Dhe Berzahu (Jeta e Varrit)

Duke iu drejtuar pyetjeve të parashtruara në parathënie, mund të themi se përgjigjja e këtyre pyetjeve na çon në nxjerrjen e një përfundimi, të mbështetur në të paktën në themele islame dhe kuranore. Ne do të diskutojmë themelet këtu pa hyrë në hollësi.

Pikë së pari ne jemi plotësisht të sigurtë se ka jetë pas vdekjes si pasojë e dëshmime njohëse dhe kuranore. Gjendet një botë tjetër ku do të shkojmë jeta njerëzore - jeta e çdo qenieje njerëzore - nuk përfundon me vdekjen por thjeshtë përfundon etapa e asaj jete madje dhe kur do të marrë fund kjo botë njerëzimi do të vijojë që të jetojë. Mbarë njerëzimi duke u nisur që nga Ademi (p.m.t.) dhe deri tek qenia e fundit njerëzore do të kalojë në një botë tjetër para se të vijë Ora e Ringjalljes. Kjo është çështja kryesisht dhe në parim.

Pikë së dyti sipas mësimave të besimit tonë islam jeta pas vdekjes ndahet në dy etapa: një etapë e mesme dhe një etapë e madhe ose një etapë paraprake dhe ngjarja e një jete të vërtetë të përjetshme -ashtu siç e përshkruan dhe autori i veprës me titull: **“Tefsiru ’l-Mizani” (Komentimi i Peshores)** Shejh Tabatabaiu. Sipas këtij të fundit kjo jetë është vendi i punës, sprovave dhe testeve. E ardhmja është një botë e mesme e cila cilësohet si një fushë përgatitore për vlerësimin dhe fitimin e njeriut dhe bota e tretë është bota tjetër, sfera e gjykimit, shpërblimeve dhe ndëshkimeve. Bota e mesme është ajo që quhet berzah (jeta e varrit ose purgatori) dhe gjithashtu e njohur si sfera e varrit.

Si rrjedhojë midis kësaj jete dhe botës tjetër, gjendet një etapë e mesme e cila quhet “berzah” (jeta e varrit) në terma teologjikë islamë. Kjo etapë zë fill nga çasti i vdekjes dhe i zhvendosjes së njeriut nga kjo botë dhe vazhdon deri sa Allahu do në orën vendimtare, pra në ditën e ringjalljes e cila nuk ka dyshim se do të vijë - kjo është sfera e berzahut. Etapa e kësaj të fundit natyrisht se ndryshon nga një njeri në tjetrin, duke u mbështetur në periudhën kohore që një njeri ka kaluar në të. Ati ynë Ademi dhe nëna jonë Hauaja (p.m.t.) kanë qëndruar në berzah që nga çasti i vdekjes së tyre dhe ende janë duke qëndruar deri në ditët e sotme dhe do të vijojnë të qëndrojnë deri në orën e fundit. Prandaj koha që ata do të kalojnë në këtë botë do të jetë më e gjatë se secila nga ne... Megjithatë të tërë do të arrijnë përfundimisht në këtë etapë; të tërë ata të cilët janë zhdukur dhe ata të cilët do të kalojnë do të shkojnë tek berzahu. Ashtu siç e theksuam më parë nuk mund ta dimë sa gjatë do të zgjasë kjo etapë sepse vetëm Allahu i Plotfuqishëm e di kur do të vijë Ora e Ringjalljes.

Kuptimi i drejtpërdrejtë dhe fjalë për fjalë i termit “berzah” në gjuhën arabe është një perde, vello ose pengesë e cila qëndron midis dy gjërave. Kështu “berzahu” është velloja dhe pengesa barriera ndërmjet atyre të cilët kanë kaluar nga kjo jetë dhe në botën tjetër duke i penguar ata nga bota tjetër, ndërsa janë në pritje të vullnetit hyjnor, duke lejuar ringjalljen dhe mbledhjen e të tërë njerëzve që kur Ademi të zërë vend dhe t’i rrethojë ata nga çdo drejtim. Kjo do të thotë se ata nuk do të kenë mundësi që të kalojnë në botën tjetër para se të ndodhë Vullneti Hyjnor dhe që të kthehen dhe në këtë botë pa lejen e Allahut. Prandaj ata janë të mbyllur në mes të kësaj jete dhe botës tjetër.

Pas berzahut vjen etapa e ardhshme; etapa e ringjalljes së fundit dhe kalimi në jetën e përhershme, e cila fillon kur Allahu, i Lartësuar është Ai, e rikrijon këtë botë dhe njerëzit

dëshmojnë atë të cilët lexojnë në ajetet e Kur'anit Fisnik për ngjarjet e Ditës së Ringjalljes, dita kur toka u shndërrua në një tokë tjetër dhe në qiej dhe ato do t'i paraqiten para Allahut, Një dhe të Gjithëfuqishëm. Dita kur Allahu do t'i ngrëjë të tëra qeniet e gjalla nga të vdekurit dhe do t'i mbledhë ata në shkretëtirën e ringjalljes për gjykimin - këtu ngjarjet e jetës tjetër dhe ringjallja përfundimtare filluan.

Ndërhyrja E Qenies Së Jetës Së Varrit

Dijetarët dhe komentatorët e mbështetën përfundimin e tyre të ndërhyrjes së qenies së jetës së berzahut (jetës së varrit) kryesisht në ajetet e Kur'anit të Shenjtë. Allahu, i Lartësuar është Ai, thotë: ***“Kur njërit nga ata u vjen vdekja ai thotë: “Oh Zoti im! Kthemë pas që unë të veproj me drejtësi në atë që kam lënë pas”. Kurrën e kurrës! Këto janë fjalë të thjeshta që ai thotë: “Dhe para tyre gjendet një pengesë deri në ditën kur ata do të ringjallen. Kur t'i fryhet surit (bririt) në atë ditë nuk do të ketë lidhje midis tyre as nuk do të pyesin (për) njëri-tjetrin”. (Sure Muminun, Ajetet 99-101).***

Këto ajete bëjnë me shenjë tek beteja e vdekjes kur një njeri e kupton se ai është duke u zhveshur nga shpirti i tij dhe se ai ka arritur në etapën e zhvendosjes dhe të largimit nga kjo botë. Ai e lut Allahun duke thënë: ***“Oh Zoti im! Kthemë!”*** Në këtë pikë, ai e ndjen se e ka kuptuar rrezikun e afërt dhe e kupton se jeta ka mbaruar dhe bashkë me të kanë mbaruar dhe mundësitë për të vepruar. Ai e kupton se po kalon në jetën tjetër. Ai dëshmon gjendjen e vdekjes së tij dhe largimin e shpirtit nga trupi i tij. Të vërtetat e botës tjetër siç thuhet në përcjellje do të fillojnë të zbulohen para syve të tij. Në këtë çast ai e ndjen fatin e tij të pashmangshëm kështu që ai lutet për një shans tjetër për t'u kthyer. E tërë kjo gjendje ndodh përpara etapës se të hyjë në xhennet ose në xhehennem, sepse kjo fillon gjatë betejës së vdekjes së dikujt kështu që njeriu i cili po vdes përgjërohet kështu: ***“O Zoti im! Kthemë, që unë të veproj me drejtësi në atë që kam lënë pas!”***

Megjithatë atij i thuhet: ***“Këto janë fjalë të thjeshta që ai thotë” dhe para tyre është pengesë deri në ditën kur ata do të ringjallen***, që do të thotë se një qenie njerëzore që nga çasti i vdekjes së tij deri në çastin e ringjalljes së tij do të banojë në një fushë të veçantë dhe brenda një pengese (berzahu). ***Kur t'i fryhet surit (bririt) në atë ditë nuk do të ketë lidhje midis tyre as nuk do të pyesin (për) njëri-tjetrin***. (Sure Muminun, Ajetet 99-101)ata do të përballen me vlerësimin e tyre në shkretëtirën e ringjalljes. Prandaj njeriu kalon nëpër një etapë kalimtare midis vdekjes dhe ringjalljes së tij për t'u përballur me gjykimin të quajtur berzah. Ajetet kuranore të lartpërmendura e tregojnë qartë këtë kuptim. Përveç këtyre ajeteve ka shumë përcjellje të cilat përmendin imtësitë lidhur me këtë botë. Gjithashtu gjenden dhe shumë ajete të tjera të cilat flasin për këtë çështje, por do të përmbahemi nga përmendja e tyre në mënyrë që të përqendrohemi në themelet e kësaj çështje në fjalë.

Përpunimi I Etapave Të Jetës Së Varrit

Pikë së pari do të nxjerrim në pah një çështje doktrimore të qëndrueshme, për të cilën mund të themi se të tërë muslimanët janë të njëzëri - përveç disa që kanë një mendim të ndryshëm - pas varrosjes së një njeriu të vdekur, Allahu, i Lartësuar është Ai, dërgon dy engjëj të nderuar, të cilët e pyesin për një numër parimesh. Ata e pyesin për Zotin, fenë dhe të dërguarin e tij dhe nëse ai përgjigjet në mënyrë të saktë dhe në dritën e veprimeve dhe jetës së tij në këtë

Të tëra përcjelljet pajtohen se pasi një qenie njerëzore është varrosur në varrin e tij, dy engjëj vijnë tek ai dhe e pyesin për Zotin, fenë dhe të dërguarin e tij, si dhe çështjet fetare dhe doktrinare fetare të jetës së tij. Sipas asaj që është përcjellur engjëjt quhen Munker dhe Nekir. Sërish është përcjellur se Imam Zejnulabdiddini (p.m.t.) ka thënë: **“Kur të vijë fundi juaj dhe engjëlli (i vdekjes) e shtrëngon shpirtin tuaj dhe ju keni mbërritur në një vendbanim të vetëm, shpirti juaj u është dhënë ju dhe Munker dhe Nekiri do t’iu sulmojnë për t’iu marrë në pyetje dhe t’ju vënë në provë në mënyrë të rreptë. Në të vërtetë pyetja e parë që do t’iu pyesin, është se cili është Zoti juaj që adhuroat, i dërguari juaj që iu është dërguar, feja tuaj që keni ndjekur, libri juaj që keni lexuar dhe imami juaj që keni ndjekur dhe pastaj për jetën tuaj dhe mënyrën se si e shpenzuar atë dhe paratë tuaja dhe si e keni arritur dhe e keni shpenzuar atë, prandaj kini kujdes dhe kujdesuni për veten dhe përgatituni për t’u përgjigjur përpara se të viheni në provë, të merreni në pyetje dhe të sprovoheni”.** (Imam Kulejni, *“Mizanu’l-Hikmeti”* (Peshorja e Urtësisë), vëll. 8, fq. 3278, Hadithi Nr: 16259)

Rishtas Imam Sadiku (p.m.t.) ka rrëfyer kështu: **“Kur një besimtar vdes, shtatëdhjetë mijë engjëj marrin pjesë në xhenazën e tij; kur të hyjë në varr, Munker dhe Nekiri vijnë tek ai dhe i parashtrojnë pyetjet duke e pyetur atë: “Kush është Zoti yt? Cila është feja jote? Dhe kush është i dërguari yt? Besimtari përgjigjet: “Zoti im është Allahu, i dërguari im është Muhammedi dhe feja ime është Islami”. Në atë çast varri zgjerohet aq sa syri mund të shohë dhe ushqimet e xhenetit do të sillen aty për të dhe flladi i xhenetit do ta mirëpresë atë”.** (Imam Sadiku, *“Eamali”* (Veprat), kreu. 48, Hadithi Nr: 12)

Imam Sadiku (p.m.t.) duke u mbështetur në dukurinë se një njeri i vdekur është marrë në pyetje në varr në mënyrë të hollësishme shprehet si më poshtë: **“Një njeri i vdekur në varrin e tij pyetet rreth pesë çështjeve: për namazin e tij, zekatin e tij, haxhxin e tij, agjërimin e tij, adhurimin e tij (uilajetin - kujdestarinë) tek ne Ehli Bejti dhe pastaj uilajeti (kujdestaria) thotë nga njëra anë e varrit në katër anët e tjera: “Cilado qoftë e meta jote unë do ta përsos atë”.** (Imam Kulejni, *“Usulu Mine’l-Kafi”* (Mënyra e Mjaftuesit), Libri i *“Xhena’iz”* (Xhenazetë), Kreu i *“Marrjes në Pyetje në Varre, Cili Është Marrë në Pyetje dhe Cili Nuk Është Marrë në Pyetje”*, Hadithi Nr: 15). E thënë ndryshe është e qartë se sipas përmbajtjes së përcjelljeve të tjera, pyetja nuk kufizohet vetëm në gjërat e bëra të qarta në këtë të fundit. Duket sikur rrëfimi na kujton gjërat tjera për t’u pyetur, përveç pyetjeve rreth Zotit, fesë dhe të dërguarit, por Allahu e di më së miri. Gjithashtu ka shumë rrëfime që lajmërojnë për pyetjen në varr, por nuk mund të përmendet këtu për botën e shkurtësisë që ai ishte një person i drejtë, ata - sipas përcjelljeve - do t’ua drejtojnë atë engjëjve të begatisë dhe lumturisë. Nëse ai megjithatë nuk i jep përgjigjet e duhura, ose shpreh atë të cilën pasqyrojnëndhët e tij të padrejta në këtë jetë, atëherë ata do t’ua dorëzojnë atë engjëjve të ndëshkimit dhe torturës ku ai do të vuajë në atë varr dhe me të vërtetë kjo është shumë e ashpërdhe një çast vendimtar. Fati i tij vendoset mbështetur në të; nëse ai do të renditet në mesin e (të bekuarve) në lumturi - përveç formave dhe këndvështrimeve të tij në berzah - ose midis (të mallkuarve) në mjerime, vuajtje dhe poshtërim - përveç shkallës dhe pikëpamjeve të tyre si dhe në berzah. Të tëra këto dukuri përmenden në përcjellje.

Kjo është përmendur në mënyrë të imtësishme të cilat ndryshojnë nga një përcjellje në tjetër, por në përgjithësi ato përcjellin të njëjtin kuptim. Në këtë këndvështrim Imam Sadiku (p.m.t.) ka përshkruar: **“Munker dhe Nekiri do të vijnë tek të vdekurit pas varrosjes. Zërat e tyre janë si bubullima gjëmuese, sytë e tyre janë si rrufeja e shpejtë dhe krahët e tyre prekin**

tokën. Ata do ta pyesin të ndjerin: “Kush është Zoti yt dhe cila është feja jote?” Nëse ai ishte besimtar atëherë do të përgjigjet: “Allahu është zoti im dhe Islami është feja ime” dhe pastaj ata i thanë: “Çfarë ke për të thënë për njeriun që doli nga mesi juaj?” Më pas ai do të pyesë: “A po më pyesni për Muhammedin të dërguarin e Allahut (p.q.m.t.)?” Kështu ata vijnë ta pyesin pyetën: “Ti dëshmon se ai është i dërguari i Allahut (p.q.m.t.)?” Ai thotë: “Unë dëshmoj se ai është i dërguari e Allahut (p.q.m.t.)”. Prandaj ata do t’i thonë: “Fli gjumë tani që nuk ka ëndrra dhe pastaj varri i tij zgjerohet nëntë “zira” (njësia matëse e krahut), një derë hapet në qiell dhe ai e sheh vendin e tij atje”. Mirëpo nëse ai ishte një jobesimtar, atëherë ata hynë dhe gjejnë shejtanin duke qëndruar para tij dhe ata e pyesin: “Kush është Zoti yt dhe cila është feja juaj? Çfarë keni për të thënë për njeriun që doli nga mesi juaj?” Ai do të përgjigjet: “Unë nuk e di ...” Kështu që ata e lënë shejtanin të lirë, i cili i lë të lirë nëntëdhjetë e nëntë dragonj të cilët nëse njëri nga ata do të frynte në tokë, asnjë pemë nuk do të rritej më dhe një derë në xhehennem hapet dhe ai e sheh vendin e tij atje”. (Imam Kulejni, “Usulu Mine’l-Kafi” (Mënyra e Mjaftuesit), Libri i “Xhena’iz” (Xhenazetë), Kreu i “Marrjes në Pyetje në Varre, Cili Është Marrë në Pyetje dhe Cili Nuk Është Marrë në Pyetje”, Hadithi Nr: 7). Kur Imam Bakirit (p.m.t.) u pyet për pyetjen në varr ai u përgjigj: “Rreth dëshmisë së gjallë (Huxhhetit) në mesin tuaj”.

Një besimtar është pyetur: “Çfarë thua për këtë?” Ai do të përgjigjet: “Ky është imami im”, kështu që atij iu thuhet: “Fli gjumë, Allahu t’i qetësoftë sytë!” Më pas një derë nga xhenneti hapet për të dhe ai vazhdon të gëzojë flladin e saj deri në Ditën e Ringjalljes. Më tej jobesimtari do të pyetet: “Çfarë thua për këtë?” Ai do të përgjigjet: “Unë kam dëgjuar për të, por nuk e di se kush është” dhe pastaj do t’i thuhet: “Po ti e dije” dhe pastaj një derë nga xhehennemi hapet për të dhe ai vazhdon të ndjejë nxehtësinë e saj deri në Ditën e Ringjalljes”. (Imam Kulejni, “Usulu Mine’l-Kafi” (Mënyra e Mjaftuesit), Libri i “Xhena’iz” (Xhenazetë), Kreu i “Marrjes në Pyetje në Varre, Cili Është Marrë në Pyetje dhe Cili Nuk Është Marrë në Pyetje”, Hadithi Nr: 8), duke përfshirë këtu dhe përcjellje të tjera.

Pas kësaj etape njeriu përjeton një skenë shumë të vështirë dhe të tmerrshme, e cila përfshin orët dhe ditët e para në varr. Kur një njeri udhëton nga një vend në tjetrin ose kalon nga një qytet në tjetrin në të njëjtin vend, ai ndihet i vetmuar dhe larg vendit për një periudhë të konsiderueshme kohore për shkak të ndryshimeve të cilatai has në zonën e tij, mjedisin, vendbanimin dhe lagjen, derisa ai bie në harmoni me vendin nga ana psikologjike. Kështu do të ndihej kur do të kalonte nga kjo botë në tjetrën? Tmerri i cili ballafaqohet në çastin e vdekjes, largimi i shpirtit dhe kalimi në një botë të re është e mjaftueshme për vete dhe prandaj të dërguarit (p.m.t.), imamët (p.m.t.), gnostikët më të shquar islamë dhe njeëzit e rejtë të vajtojnë duke kujtuar këto ngjarje ose kur këto çaste u vijnë në mendjet e tyre.

Kalimi në varr është kalimi nga një botë e gjerë tek një gropë të ngushtë ashtu siç përshkruhet nga Emir Mumini (Prijësi i Besimtarëve) (p.m.t.): “Në fund të fundit një varr është një gropë dhe madje dhe nëse është bërë shumë e madhe dhe e gjerë, koha ngadalë ngadalë do të zvogëlojë madhësinë e saj dhe do ta mbushë me dhé dhe gurë”. (Imam Aliu (p.m.t.), “Nahxhu’l-Balaga” (Kulmi i Oratorisë), Letra e 45 dërguar Uthman Ibn Hunejfi Ensariut). Pra varri është kalimi në vendbanimin e izolimit, vetmisë dhe frikës; ai shtëpia e krimbave, tmerri dhe ankthit, ku një njeri është lënë i vetmuar dhe i braktisur dhe i cili nuk ka as mbrojtës dhe as ndihmës. Nëse dikush do të flasë askush nuk do ta dëgjojë zërin e tij, as nuk do të ishte në gjendje të bëjë asgjë për ta bërë më të mirë gjendjen e tij të tmerrshme.

Varri është vendbanimi i dobësisë dhe i varfërisë së plotë. E tërë kjo do të përjetohet kur njeriu të arrijë në varr.

Kjo e vërtetë tregon se kjo botë është e karakterizuar nga zbulimi i të vërtetës. Në këtë botë të zakonshme, një njeri gabohet në të vërtetën e tij duke besuar se ai ka fuqi, pasuri, begati e kështu me radhë. Ku në të vërtetë sikur të mos ishte për dhënien e diturisë, pasurisë dhe nderimit, ai do të ishte vetëm i dobët, i varfër dhe i paditur. Në atë botë të vërtetat do të dalin në shesh dhe do të zbulohen dhe dobësia, varfëria, padituria dhe pafuqiado të tregohen shumë qartë.

Për më tepër unë dua që të shtoj në atë që është sipërcituar - dhe në atë që është thënë gjithashtu nga përcjelljet- se trysnia e varrit gjatë ditëve të para ose orëve të para pasi një njeri është vendosur në varrin e tij, ose në atë e cila quhet dhe si kapja apo shtrëngimi i varrit nga e cila do të shpëtojnë vetëm disa njerëz sipas përcjelljeve të rrëfyera nga sunnitët dhe shiitët dhe muslimanët në përgjithësi. (Trysnia e varrit është një besim i vendosur në shariatin islam dhe shumica e njerëzve do t'i nënshtrohen asaj. Ehli Bejti iu është drejtuar kësaj çështjeje në një numër përcjelljesh, të tilla si hadithi ku thuhet se Imam Sadiku (p.m.t.) ka thënë për vlerësimin e njeriut në varr: “Njeriudo të vihet në pikëpyetje kur do të jetë nën trysninë (e varrit)”. (Imam Kulejni, “Usulu Mine'l-Kafi” (Mënyra e Mjaftuesit), Libri i “Xhena'iz” (Xhenazetë), Kreu i “Marrjes në Pyetje në Varre, Cili Është Marrë në Pyetje dhe Cili Nuk Është Marrë në Pyetje”, Hadithi Nr: 5), si dhe përgjigja e Imam Sadikut (p.m.t.) kur u pyetën: “Kush do të shpëtojë nga trysnia e varrit?” Imami u përgjigj: “Ne kërkojmë strehim tek Allahu nga ajo. Me të vërtetë shumë pak njerëz shpëtojnë nga trysnia e varrit”.(Imam Kulejni, “Usulu Mine'l-Kafi” (Mënyra e Mjaftuesit), Libri i “Xhena'iz” (Xhenazetë), Kreu i “Marrjes në Pyetje në Varre, Cili Është Marrë në Pyetje dhe Cili Nuk Është Marrë në Pyetje”, Hadithi Nr: 6).

Kjo është një çështje që kërkon ndjeshmëri, njohuri, përgatitje dhe masa paraprake, ashtu siç përmendet në ajetin kuranor që filluam (me kuptimin dhe përpunimin e etapave të jetës së varrit) dhe për varrin i cili është vendi i parë i botës tjetër. *“A është ai i cili lutet në orët e natës duke u përulur (në gjunjë) dhe duke qëndruar (në këmbë) i shqetësuar nga bota tjetër dhe duke pritur mëshirën e Zotit të tij? Thuaj: “A janë ata të barabartë ata të cilët dinë me ata të cilët nuk dinë?” Vetëm ata të cilët janë të zotët e mendjes marrin këshillë” (Sure Zumer, Ajeti 9).*

Pas kësaj etape - pas ardhjes së engjëjve, pas marrjes në pyetje njeriut dhe të etiketimit të tij si të bekuar ose të mallkuar - çfarë do të ndodhë? Ku do të shkojnë njerëzit pas kësaj? Gjendet një diskutim me dëshmi në të cilin ishin paraqitur pikëpamjet filozofike dhe kuranore; por ky nuk do të trajtohet këtu si pasojë e kohës së shkurtër. Ne do të marrim vetëm pikëpamjet e miratuara dhe të përbashkëta të cilat mbështeten në provat kuranore si dhe disa hadithe të vërteta.

Ndarja E Njerëzve Në Berzah

Të tëra dëshmitë tregojnë se njerëzit janë ndarë në klasa në berzah: Klasa e parë janë të torturuarit të cilët nuk do të gëzojnë kurrë lumturi, klasa e dytë janë të lumturit të cilët nuk do të torturohen kurrë dhe klasa e tretë do të trajtohet më vonë. Në çastin e largimit të klasës së parë nga kjo botë, ata do të pranohen nga engjëjt në një mënyrë të dhunshme dhe poshtëruese, torturohen dhe dënohen në mënyra të ndryshme.

Kush Janë Këta Njerëz?

Para se t'u përgjigjemi kësaj pyetjeje, ne do të qëndrojmë mbi një shpallje kuranore e cila i drejtohet në mënyrë të hollësishme torturës së cilës i nënshtrohet klasa e parë. Sa i përket tregimit të të dërguarit Musa (p.m.t.) dhe firaunit, Kur'ani Famëlartë përshkruan rrethanën e kësaj klase, pasi Allahu duke iu drejtuar Musait i thotë: ***“Pastaj Allahu e shpëtoi atë nga kurthet e tyre të këqija ndër kohë që një dënim i tmerrshëm rrethoi njerëzit e firaunit”.*** (SureGafir, Ajeti 45). Më tej Allahu sqaron domethënien e kësaj torture të tmerrshme duke e ndarë atë në dy pjesë: E para përmendet në këtë ajet: ***“Zjarri në të cilin ata digjen në mëngjes dhe në mbrëmje”.*** (SureGafir, Ajeti 46). E dyta përmendet në këtë ajet: ***“Në ditën kur të vijë Ora, njerëzit e firaunit do të hyjnë në dënimin më të rëndë”.*** (Sure Gafir, Ajeti 46). Prandaj pjesa e parë është kur ata do të digjen në zjarrin e xhehennemin në mbretërinë e berzahut dhe e dyta është vuajtja që ata do të vuajnë kur të vijë Ora ku ata do të qëndrojnë përgjithmonë në atë vend të torturës. Megjithatë mund të kërkohet dëshmia se pjesa e parë i drejtohet komentuesve të berzahut dhe dijetarët fetarë shprehen se pjesa e parë e provave të tekstit të mësipërm është përmendja e mëngjesit dhe mbrëmjes në ajet, duke vënë në dukje se nuk ka ditë e natë në xhehennemin e ringjalljes përfundimtare; Ajeti i qartë tregon se ata do të digjen në zjarr çdo mëngjes dhe mbrëmje duke ilustruar se kjo ndodh para se të hyjë në xhehennem në botën tjetër.

Dëshmia e dytë e tekstit është segmenti vijues i ajetit kur Allahu thotë: ***“Në ditën kur të vijë Ora, njerëzit e firaunit do të hyjnë në dënimin më të rëndë”.*** Ai tregon qartë se Ora nuk ka ardhur ende, duke treguar se kjo djegie në zjarr ndodh përpara ardhjes së Orës, kështu që këta njerëz digjen në zjarr çdo mëngjes dhe mbrëmje përpara dhe kur të vijë koha. Ai thotë:

Tani le t'i rikthehemi pyetjes: Cila është klasa e parë? Firauni nuk përmendet vetëm në këtë drejtim, pasi kjo klasë përfshin të tërë firaunët, nimrudët, dhunuesit, shtypësit dhe tiranët në çdo epokë dhe kohë, siç janë Ebu Xhehli (*Amr Ibn Hisham Ibn Mugire nga fisi kenane, i cili ishte një nga udhëheqësit kurejshë gjatë ardhjes së Islamit. Ai ishte i njohur për kundërshtimin e tij të ashpër të Islamit dhe madje ishte një nga armiqtë kryesorë të të dërguarit Muhammed (p.q.m.t.) dhe ndjekësve të tij. Ai si fillim u quajt Ebu Hikemi (Ati i Diturisë, Urtësisë), mirëpo i dërguari i Allahut (p.q.m.t.) e quajti atë Ebu Xhehli (Ati i Paditurisë) pasi vrau një grua të vjetër pasi ajo shpalli hapur se kishte përqaftuar Islamit*), Ebu Lehebi (Abduluzza Ibn Abdulmuttalib, xhaxhai nga ana e të atit të të dërguarit Muhammed (p.q.m.t.)). Emri i tij i vërtetë ishte Ebu Utbe, duke iu mbështetur të birit të tij të madh Utbes, por i ati i tij e quajti atë Ebu Leheb (Ati i Flakës) si pasojë e bukurisë dhe sharmit të tij. Ai ishte i pari i cili e shprehu armiqtësinë e tij ndaj Islamit kur i dërguari i Allahut (p.q.m.t.) nisi të bëjë të ditur “dauetin” (thirrjen) në Islam. Ai është përmendur në Kur'anin Fisnik në Suren Mesed: ***“Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi dhe e ai më është i shkatërruar! Atij nuk i bëri dobi as pasuria e tij dhe as ajo çfarë fitoi! Së shpejti ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë. Ndërsa gruaja e tij ajo e cila barti dru zjarri, do të ketë një litar palme të përdredhur rreth qafës së saj”.*** (Sure Mesed, Ajetet 1-5), si dhe të tërë kurejshët të cilët luftuan kundër të dërguarit të Allahut (p.q.m.t.) duke u mbështetur në thënie të përcjelljeve, përfshin ata të cilët ishin jobesimtarë rrënjësorë, dhunues, shtypës dhe tiranë. Ky ajet dëshmon për një numër pyetjesh, sepse ai tregon se ka një etapë të mesme e cila është barzahu. Cilido që është i tillë nuk do të pushojë kurrë në paqe. Sipas Imam Husejnit (p.m.t.) ai zgjodhi jetën e kësaj bote që të jetë xhenneti i tij. Kjo do të thotë se ai zotëronte pallate, pasuri, autoritet, shërbëtorë dhe njerëz dhe gëzonte pasuritë e tij duke shuar të tëra dëshirat e

tij të kësaj bote megjithatë, ajo mori fund me vdekjen. Nga çasti i parë i largimit të shpirtit, ai përballet me vuajtjen, turpin, mjerimin dhe poshtërimin.

Një numër i madh përcjelljesh të rrëfyera nga Ehli Bejti (p.m.t.) shënjojnë pyetjen e dy engjëjve në varr, në të cilat i nënshtrohen vetëm dy klasa njerëzish: besimtarët krejtësisht të pastër dhe jobesimtarët e plotë. Ata janë dy të parët të përmendur në klasat në fjalë: “Në këtë pikëpamje Imam Sadiku (p.m.t.) thotë: *“Askush nuk është marrë në pyetje në varr, përveç besimtarit krejtësisht të pastër ose jobesimtarit krejtësisht të pastër dhe pjesa tjetër është lënë jashtë”*. (Imam Kulejni, *“Usulu Mine’l-Kafi” (Mënyra e Mjaftuesit), Libri i “Xhena’iz” (Xhenazetë), Kreu i “Marrjes në Pyetje në Varre, Cili Është Marrë në Pyetje dhe Cili Nuk Është Marrë në Pyetje”, Hadithi Nr: 1*). Sërish ai citon: *“Askush nuk është marrë në pyetje në varr, përveç besimtarit krejtësisht të pastër ose jobesimtarit krejtësisht të pastër dhe pjesa tjetër është lënë jashtë”*. (Imam Kulejni, *“Usulu Mine’l-Kafi” (Mënyra e Mjaftuesit), Libri i “Xhena’iz” (Xhenazetë), Kreu i “Marrjes në Pyetje në Varre, Cili Është Marrë në Pyetje dhe Cili Nuk Është Marrë në Pyetje”, Hadithi Nr: 2*). Rishtas i ati i tij Imam Bakiri (p.m.t.) kumton: *“Askush nuk është marrë në pyetje në varr, përveç besimtarit krejtësisht të pastër ose jobesimtarit krejtësisht të pastër dhe pjesa tjetër është lënë jashtë”*. (Imam Kulejni, *“Usulu Mine’l-Kafi” (Mënyra e Mjaftuesit), Libri i “Xhena’iz” (Xhenazetë), Kreu i “Marrjes në Pyetje në Varre, Cili Është Marrë në Pyetje dhe Cili Nuk Është Marrë në Pyetje”, Hadithi Nr: 3*).

Për më tepër ajetet dhe përcjelljet e lartpërmendura lajmërojnë se ka jetë në atë botë, sepse nuk mund të flitet për vuajtje kundër trupave të pajetë; vetëm të gjallët janë të munduar. Më tej tregon se ka një lloj xhehennemi në berzah, përveç zjarrit të përjetshëm të xhehennemit. Dhuna dhe vuajtja në berzah nuk mund të krahasohet me dënimin e pritur në Ditën e Ringjalljes, sepse është më pak e rëndë. Nëse vuajtja në Ditën e Ringjalljes nuk ishte më e tmerrshme se ajo në berzah, atëherë Allahu nuk do të thoshte: *“Në ditën kur të vijë Ora, njerëzit e firaunit do të hyjnë në dënimin më të rëndë”*. Si rrjedhojë është e sigurtë të thoni gjithashtu se lumturia në Ditën e Ringjalljes e tejkalon lumturinë në berzah. Disa përcjellje rrëfejnë se ata të cilët u torturuan në berzah do të pohojnë: *“Zoti ynë! Mos lejo që ringjallja të ndodhë”*, sepse ata e dinë se ajo çfarë po i pret është dhe më e rëndë. Përsëri është përcjellur se Imam Sadiku (p.m.t.) ka përshkruar: *“Shpërtrat e jobesimtarëve do të digjën në zjarrin e xhehennemit dhe do të thonë: “Zoti ynë! Mos lejo që Ora të vijë, mos e përmbushni atë për të cilën na ke dhënë fjalën”*. (Imam Kulejni, *“Mizanu’l-Hikmeti” (Peshorja e Urtësisë), vëll. 1, Hadithi Nr: 1694*), në kundërshtim me ata të cilët gëzojnë begatitë në berzah të cilëve lusin Zotin e tyre për ta lënë atë kohë të vijë, sepse ata gëzohen në një lumturi më të lartë dhe më të madhe. Ai (p.m.t.) tha: *“Shpërtrat e besimtarëve janë në dhomat e xhennetit; ata hanë nga ushqimi i tij, pijnë pijet e tij dhe vizitojnë njëri-tjetrin. Ata thonë: “Zoti ynë! Le të vijë Ora kështu që do të mund të përmbushësh atë për të cilën na ke dhënë fjalën”*. (Imam Kulejni, *“Mizanu’l-Hikmeti” (Peshorja e Urtësisë), vëll. 1, Hadithi Nr: 1689*).

Sa u përket klasës së e dytë, sërish sipas përcjelljeve ajo përfshin ata të cilët janë besimtarë krejtësisht të pastër; si ata të cilët kishin besim të delirë, të kulluar dhe të pastër, siç janë lajmëtarët, të dërguarit, imamët e pagabueshëm, si dhe dëshmorët - rrethanat e të cilëve do të flasim shkurtimisht sipas ajeteve të Kur’anit të Shenjtë. Shihni përcjelljet e lartpërmendura të zbuluara në një shënim të mëparshëm për klasën e parë të njerëzve. Nuk ka dyshim se këta njerëz- klasa e dytë - do të hyjnë në një etapë lumturie në çastin kur ata largohen nga kjo botë

e zakonshme. Ata largohen për lumturinë e Allahut dhe kënaqen me kënaqësinë e Tij, për sigurinë dhe mbrojtjen e Allahut, për mirëqenien, paqen dhe dinjitetin dhe për atë që Allahu, i Lartësuar qoftë Ai, ka përgatitur për ta.

Një Vështrim I Shpejtë I Gjendjes Së Dëshmorëve Në Berzah

Ajetet kuranore, të cilat shënjojnë veçanërisht gjendjen edëshmorëve në berzah, theksojnë një shpallje të këndshme në këtë drejtim. Allahu thotë kështu në Librin e Tij të Shenjtë: ***“Mos i quani ata të cilët u vranë në udhën e Allahut “të vdekur”. Jo ata janë të gjallë por ju nuk kuptoni”.*** (Sure Bekare, Ajeti 154), në një adresë për të tërë njerëzit nga epoka e të dërguarit tonë (p.q.m.t.) deri në këtë ditë dhe derisa të vijë Ora. Kjo thënie në ajet i ndalon njerëzit që t'i quajnë dëshmorët në mesin e të vdekurve si të tjerët, duke i udhëzuar ata që këta njerëz janë midis të gjallëve, tani në këtë etapë përpara se të vijë Ora, siç janë ata të cilët jetojnë por ju nuk e kuptoni ***“Mos i quani ata të cilët u vranë në udhën e Allahut “të vdekur”. Jo ata janë të gjallë por ju nuk kuptoni”.*** (Sure Bekare, Ajeti 154).

Rishtas gjendet dhe një ajet më i qartë për të njëjtën përmbajtje i cili thotë kështu: ***“Assesi mos mendoni se ata të cilët u vranë në udhën e Allahut janë “të vdekur”, përkundrazi ata janë të gjallë duke u furnizuar tek Zoti i tyre”.*** (Sure Ali Imran, Ajeti 169), që do të thotë se ata janë të gjallë, duke jetuar dhe furnizimi me të cilin janë siguruar siç përmendet në ajete e siërcituar nuk do të thotë ushqim, pije e para, por diçka më të lartë për nga rëndësia; ata janë duke u pajisur me dinjitet, nder, shkallë të larta, paqe, siguri, lehtësi, lumturi dhe shumë bekime të tjera.

“Assesi mos mendoni se ata të cilët u vranë në udhën e Allahut janë “të vdekur”, përkundrazi ata janë të gjallë duke u furnizuar tek Zoti i tyre”. Ata janë të gëzuar me atë që ua ka dhënë Allahu nga të mirat e Tij dhe atyre që u ka mbetur ende pa i bashkuar rradhëve të tyre, përgëzohen se për ta nuk ka as frikë dhe as nuk kanë përse të shqetësohen”. (Sure Ali Imran, Ajeti 169-170)

Ata janë të gëzuar për vëllezërit, shokët, të dashurit dhe miqtë e tyre, të cilët janë ende gjallë në jetën e kësaj bote dhe u drejtohen atyre duke thënë: “O ju vëllezër, të cilët jeni ende duke banuar në jetën e kësaj bote, vetëm nëse mund ta dini se në çfarë lumturie dhe bukurie jetojmë; sa dritë, paqe dhe dinjitet dhe pranë cilit jemi? Ju nuk do ta mbanimë veten e as nuk do të toleroni që të jetoni në atë botë për një të dytë? Megjithatë sytë tuaj janë të fshehur dhe jeni të pakujdesshëm dhe harroni. ***“Ata janë të gëzuar me atë që ua ka dhënë dha Allahu nga të mirat e Tij dhe atyre që u ka mbetur ende pa i bashkuar rradhëve të tyre, përgëzohen se për ta nuk ka as frikë dhe as nuk kanë përse të shqetësohen. Ata janë të gëzuar me begati e dhurata që ua ka dhënë Allahu dhe nuk ka dyshim se Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve”.*** (Sure Ali Imran, Ajeti 170-171)

Përmendja E Klasës Së Tretë

Pasi kemi folur për dy klasat e para, tani do të përmendim pjesën tjetër të njerëzve e cila nuk përfshihet në ato palë. Ka rrëfime dhe pikëpamje të ndryshme për këtë çështje madje dhe brenda të njëjtit sekt. Meqë kjo çështje është një hulumtim teologjik i cili kërkon një diskutim të gjatë, nuk do të nxjerrim një përfundim vendimtar por do të paraqisim vetëm një numër mendimesh. Ka dijetarët e cilët cilësojnë se klasa e tretë e njerëzve, pas marrjes në pyetje - dhe pasi ujanë nënshtruar etapës së parë të ngjarjeve të cilat ndodhin në varr, duke përfshirë shtrëngimin dhe trysninë e varrit dhe ose do t'u jepet lumturi ose të përballen me zemërimin e

Allahut - ata do të lihen jashtë dhe engjëjt nuk do të merren më me ta. Megjithatë dijetarët nuk e sqarojnë çështjen në mënyrë të imtësishme.

Gjendet dhe një mendim tjetër i cili bën të ditur se nëse i vdekuri cilësohet të jetë më i ulët se ai i klasës së dytë (ata të cilët janë besimtarë krejtësisht të pastër), ai do të pushojë dhe engjëjt do të hapin një dritare ose derë nga xhenneti dhe kështu ai do të ketë një shije të flladit të tij, të paqes dhe të lumturisë - dhe vetëm Allahu e di se çfarë do të kalojë ky njeri në këtë kohë - ai do të pushojë dhe do të zgjohet vetëm kur të fryhet suri (briri), kur Allahu do të lejojë që Orari të vijë. Megjithatë nëse i ndjeri ishte ndër njerëzit e ligj, por jo në të njëjtin shkallë me klasën e parë (ata të cilët janë jobesimtarë krejtësisht të pastër), atëherë do të hapet një - një gropë ose dritare nga xhehenemi dhe ai do të digjet në një masë të zjarrit të tij, nxehtësisë dhe errësirës.

Për më tepër është e pranishme dhe një pikëpamje e cila shënjon se nuk ka dallim në mes të kësaj pale dhe dy klasave të para, meqenëse parimi përcakton se varri i çdo qenieje njerëzore ose do të jetë një nga kopshtet e xhennetit, ose një nga gropat e xhehenemit. Megjithatë, ka një ndryshim në shkallën e vuajtjes ose lumturisë me të cilën ata përballen, sepse vuajtja e tyre është më e vogël se ajo e klasës së parë dhe lumturia e tyre është gjithashtu më e vogël se ajo e klasës së dytë.

Për këtë arsye një njeri mrekullohet për ata të cilët kënaqen nga klasa e dytë (siç janë dëshmorët dhe të dërguarit), a do ta përjetojnë këtë lumturi në varret e tyre të cilat do të shndërrohen në kopshte të xhennetit, siç shpreh mendimi i tretë në lidhje me klasë e tretë, ose a gjenden xhennete të veçanta në berzah, të cilat ata do të dërgohen dhe do të gëzojnë lumturi atje? Sa i përket atyre të cilët vuajnë nga klasa e parë, a do t'i nënshtrohen dënimit në varret e tyre, të cilat do të shndërrohen në gropa të xhehenemit, ose a ka ndonjë zjarr të veçantë në të cilin do të hidhen? Lidhur me këtë imtësi, shtojmë se gjenden përcjellje dhe pikëpamje të ndryshme.

Morali Për Vetën Dhe Besimi

Ajo që duam që të nxjerr në pah këtu është se pavarësisht nga vlefshmëria e secilës nga tre mendimet, mjafton që të merret parasysh pikëpamja e tretë e vlefshme - unë për shembull nuk e cilësoj veten, me vullnetin e Allahut një shtypës dhe tiran. Unë shpresoj që të llogaritem në mesin e besimtarëve, por unë besoj se unë jam midis njerëzve të thjeshtë, në mesin e atyre të cilët do merren në pyetje. Sipas meje ka gjasa për t'u lënë jashtë ose për të pushuar derisa të vijë Dita e Gjykimit, por ka edhe një mundësi tjetër të ndryshme. Ajo që po përpiqem të them është se mjafton që të ketë mundësinë e fundit që thotë se çdo varr është ose një kopsht nga kopshtet e xhennetit ose një gropë nga gropat e xhehenemit dhe kjo lumturi ose mjerim fillon me vdekjen. Megjithatë sipas kushteve në berzah të cilat ndryshojnë nga ajo e Ditës së Ringjalljes, kjo mundësi është më se e mjaftueshme për të na bërë të jetojmë në një gjendje shqetësimi, paniku dhe frike dhe kujdes të skajshëm. Në fund të ditës të tërë ne jemi të nënshtrohem vdekjes në çdo çast dhe në çdo vend. Secili nga ne mund të vdesë në një vend dhe kohë të papritur.

Me të vërtetë të tërë ne do të vdesim. Allahu i drejtohet të dërguarit Muhammed (p.q.m.t.), i cili është më i dashuri i Tij, ashtu siç i rrëfen në ajetin e mëposhtëm: "Ti do të vdesësh dhe ata (gjithashtu) do të vdesin". (Sure Zumer, Ajeti 30). Të tërë ne do të arrijmë berzah dhe do të banojmë në varr për qindra, mijëra apo dhjetëra mijëra vite, pasi askush nuk e di kur do të vijë ora. Kështu që mundësia e tretë ka të ngjarë të mbështetet në logjikën dhe arsyetimin, në

shtesë ashtu siç tregohet në një numër përcjelljesh, si dhe në disa ajete kuranore, për më tepër çfarë kemi përgatitur për këtë dhe si e kemi pajisur veten?

Për këtë berzah ne vetëm po i drejtohem çështjes së berzahut dhe tani do të adresojmë ringjalljen dhe jetën e përvetshme - dhe në këtë varr, pra vendbanimin e errësirës, izolimit, vetmisë, braktisjes, vendqëndrimit të krimbave dhe larvave, lënies pa ndihmë, dobësisë, urisë dhe varfërisë, çfarë kemi përgatitur për të dhe si e kemi pajisur veten? Kjo është pyetja kryesore që kërkon nga ne si njerëz dhe palë që të ndalojmë, të kthejlohem, të mendojmë, të hulumtojmë, të planifikojmë, të punojmë çdo ditë dhe të përdorim çdo ditë, minutë, sekondë dhe çast të jetës sonë për të përgatitur dhe pajisur veten. Ndërsa përgatitemi për luftë, mbledhim dhe planifikojmë të përballojmë çështjet tona ekonomike, shoqërore, politike dhe të sigurisë, planin për martesë, arsimimin dhe karrierën dhe si e tërë kjo merr kohën tonë, e cila shpenzohet vetëm për hir të një bote të zakonshme të përkohshme, përse nuk punojmë dhe planifikojmë për një botë më të merituar (për mbretërinë e varrit) Çfarë kemi përgatitur për atë botë? Çfarë kemi përgatitur për këtë shtëpi të re dhe cilat mobilje, pasuri, armë dhe aftësi - në atë botë ato janë sigurisht të ndryshme - a kemi dërguar atje nëpërmjet veprave tona të mira? Vetëm veprat tona të mira do të jenë të vlefshme duke arritur këtë çast të parë (pas vdekjes).

Një përcjellje e rrëfyer nga Ehli Bejti (p.m.t.) bën të qartë se pasi një njeri të ketë vdekur, ky i fundit do t'i drejtohet atij tri gjërave: Përcjellja është përcjellur në veprën me titull: *“Shexheretu t-Tuba”(Pema e Tubasë)* nga shejh Muhammed Mehdi Hairiu, por nuk u vishet drejtpërdrejt të dërguarit (p.q.m.t.), ose ndonjërit nga imamët e pafajshëm (p.m.t.) dhe përmbajtja e tij përgjithësisht thotë: *“Unë kam kaluar jetën time duke iu mbledhur dhe duke iu kursyer, nëpërmjet hallallit (të lejuarës) dhe haramit (të ndaluarës) do të thotë: “Unë jam tani në telashe dhe kam një udhëtim të gjatë përpara meje çfarë do të fitoj nga ju?” Paratë do t'i përgjigjen: “Ti do të marrësh qefinin, vetëm qefinin dhe pjesa tjetër e parave tuaja do të shkojnë tek trashëgimtarët tuaj”. Kur një njeri vdes ai do të merret në pyetje për paratë e tij dhe se si i fitoi ato, me anë të hallallit (të lejuarës) apo me anë të haramit (të ndaluarës) do të thotë trashëguesit e tij; megjithatë do të jenë ata të cilët do t'i gëzojnë paratë e tij në këtë jetë. Ky njeri do të shikojë fëmijët dhe familjen e tij dhe do të thotë: “Unë iu ushqeva, iu arsimova dhe iu rrita, unë iu mbrojta dhe iu mbajta mbi supet e mia çfarë do të fitoj nga ju?” Ata do t'i thonë: “Ne do të të mbajmë mbi supet tona - dhe do të të çojmë në varrin tënd - kështu që ai nuk fiton asgjë nga ata, përveç atyre të cilët e çojnë në varrin e tij dhe e lënë atë të kalbet”. Pas kësaj dikush vjen dhe e pyet kështu: “Kush je ti?” Kjo ndodh pasi paratë e tij, fëmijët, të dashurit dhe familja e lë atë dhe pastaj kjo gjë i ngjitet atij dhe kundërshton që ta lërë atë kështu që ai pyet: “Kush je dhe pse jeni lidhur me mua? A ju njoh?” Si rrjedhojë ajo thotë: “Po unë jam vepra juaj. Që tani e tutje unë do të mbetem me ty dhe nuk do të të lë kurrë qoftë për një çast të vetëm”. Nëse këto vepra janë të mira, atëherë ato do të ndihmojnë, mbështesin dhe mbrojnë këtë njeri. Por nëse ato janë të këqija, veprime dhunuese, shtypjeje dhe tiranie mëkatet dhe keqbërjet, ai nuk do të ketë askënd që ta ndihmojë atë përveç Allahut. Sepse ky shoqërues nuk do të largohet kurrë nëse Allahu nuk dëshiron ndryshe”.*

“Kur paratë, fëmijët dhe veprat e birit të Ademit paraqiten përpara tij në në çastin e vdekjes, ai do të kthehet nga paratë e tij dhe do të thotë: “Unë isha i etur për t'iu mbledhur dhe për të arritur tokë dhe det në vapë dhe në të ftohtë për të arritur ty dhe tani po largohem dhe kam nevojë për ndihmën tënde kështu që çfarë do të bësh? Dhe si do të më

ndihmosh? “Paratë do të përgjigjen: “Merre qefinin tënd nga unë dhe shko në varrin tënd”. Allahu thotë: “Kërko vendbanimin e përjetësisë nëpërmjet asaj që të ka dhënë Allahu duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë” (Sure Kasas, Ajeti 77) (pjesa jote në këtë botë është qefini). Më pas ai do të kthehet tek fëmijë e tij dhe do t’iu thotë: “Betohem në Allahun, se shpirti im është lodhur për ju, ka mbledhur para për ju, me anë të hallallit (të lejuarës) dhe haramit (të ndaluarës), ka duruar mundime dhe vështirësitë për mbarëvajtjen e punëve tuaja dhe për të përmbushur nevojat tuaja dhe tani unë kam nevojë për ju kështu që më ndihmoni me atë që mundeni dhe kështu ata do të thonë: “Ne do t’iu kthejmë në varrin tuaj dhe do t’i vendosëm në atë gropë dhe pastaj do të kthehemi në ndërtesat, banesat dhe shtëpitë tona. Më tej pasi ka humbur shpresën në paratë dhe fëmijë e tij, ai do të kthehet tek veprat e tij të mira dhe do të thotë: “Betohem në Allahun, unë iu kam urryer dhe iu jam shmangur, por tani jam i vetëm sepse nuk kam as para për të ndihmuar dhe as fëmijë e mi për të mbrojtur mua, kështu që çfarë mund të bëni për mua?” Në këtë çast paratë përgjigjen: “Ne jemi me ty dhe nuk do të të lëmë në asnjë vend sepse ne jemi shoqëruesi dhe miku yt i ngushtë” dhe kështu ai kënaqet”. (“Shexheretu’t-Tuba” (Pema e Tubasë), vëll. 39)

Në përfundim lidhur me këtë çështjen e parë në fjalë, ne themi se ne besojmë se gjendet një botë tjetër e quajtur berzah dhe një jetë atje, ku ka ose lumturi ose vuajtje dhe sigurisht që lumturia ose vuajtja e tij nuk mund të krahasohet me atë në këtë botë të zakonshme, por përkundër kësaj, lumturia dhe vuajtja e jetës tjetër është jashtëzakonisht më e madhe. Kjo botë e berzahut e cila ka kushtet dhe ligjet e saj do të përfundojë vetëm kur të vijë Ora dhe shtylla kryesore e saj janë “veprat” tuaja. Megjithëse gjendet parimi i ndërmjetësimit, ndërmjetësimi i të dërguarve të Allahut (p.q.m.t.) në dobi të mëkatarëve dhe keqbërësve, si dhe ndërmjetësimi i Ehli Bejtit (p.m.t.) dhe dëshmorëve - dhe ne besojmë se të tërë ata kanë qenë të nderuar nga Allahu dhe qëndrojnë në shkallë të larta, të cilat u japin të drejtë atyre që të ndërmjetësojnë në emër të të tjerëve - ka shumë përcjellje, hadithe dhe pohime nga dijetarë fetarë të cilat tregojnë se ndërmjetësimi nuk zbatohet në botën e berzahut. Me fjalë të tjera nuk mund të përfitojë të them se jam unë i biri ose i ati i një dëshmori; asnjë nga këto nuk kanë dobi dhe vetëm veprat e mira do t’iu sjellin dobi, ndryshe nga bota tjetër në të cilën lejohet ndërmjetësimi. Në botën tjetër dyert e mëshirës hyjnore do të hapen dhe do të jepen dhuratat për hir të Allahut dhe vetëm Allahu e di shkallën e mëshirës që përhap në atë ditë. Pra berzahu është një botë e ashpër e cila nuk duhet të merret si e mirëqenë. Përcjelljet përmendin mundësinë e ndihmës në botën tjetër por kjo nuk është e njëjtë për berzahun. Si rrjedhojë çdo njeri duhet të punojë dhe duhet të përgatitet për veten e tij, sepse ai do të mbështetet vetëm në atë botë dhe në veprat e mira që ai ka kryer, përfshirë adhurimin, drejtësinë, veprat e mira, xhihadin, përkushtimin, mirësinë dhe pastërtinë.

Ky është një udhëtim i gjatë i cili kërkon gatishmëri të madhe dhe përgatitje për atë gjë e cila do të na ndihmonte, siç do të kërkonte çdo udhëtim normal në këtë botë. Kur dikush ngjitet në një mal apo udhëton nëpër rajonet malore, ai duhet të pajiset me veshje, transport, ushqim dhe pije të duhura për atë lloj udhëtimi. Para nesh është një udhëtim i gjatë, një udhëtim me qindra e mijëra vjet, në një fushë që ka natyrën, kushtet dhe ligjet e saj. Pra ne duhet të përgatisim veten tonë. Përgatituni Allahu iu mëshiroftë, sigurisht furnizimi më i mirë është drejtësia.

Kreu i Dytë

Fundi I Mbërritjes

Ngjarjet E Ringjalljes Së Fundit Dhe Tmerret E Saj

Ne do të vazhdojmë diskutimin tonë për çështjen e jetës pas vdekjes, Ditës së Ringjalljes dhe ngjarjet e asaj dite, duke u përpjekur që ta përmbledhim sa më shumë çështjen. Ne do të gërmojmë në hollësi të disa pikave dhe do të shqyrtojmë pika të tjera në vija të përgjithshme. Ky hulumtim do të mbështetet kryesisht në ajetet kuranore, meqenëse Kur'ani Famëlartë është burimi më i besueshëm për t'u përdorur në trajtimin e Ditës së Ringjalljes, sepse është një çështje e panjohur e cila mund të zbulohet vetëm nëpërmjet haditheve të vërteta. Por përpara se ta shtjelloj dhe të gërmoj imtësitë e çështjes në fjalë do ta paraqis shkurtimisht, sepse unë e shoh të dobishme për të dyja si për çështjen dhe diskutimin tonë këtu si dhe kuptimin e çështjeve kuranore në përgjithësi.

Hyrje: Përdorimi I Vërtetë Dhe Metaforik I Gjuhës

Them se është e mirënjohur për të tërë ne se Allahu, i Lartësuar është Ai, e dërgoi Kur'anin Fisnik në gjuhën e arabëve. Kështu që nëse dikush doqë të kuptojë Kur'anin e Shenjtë dhe kuptimet e ajeteve të tij, ai duhet të ketë njohuri për gjuhën arabe dhe gramatikën e saj. Kjo është thelbësore për të kuptuar përkufizimet dhe kuptimet e fjalëve, fjalive përbërjeve dhe strukturave të cilat në rastet kur ndryshojnë mund t'i japin një tjetër kuptim një thënie ose termi. Si rrjedhojë ne do të paraqisim llojet e përdorimit gjuhësor të fjalëve.

Gjuhëtarët arabë ndanë përdorimin e fjalëve në dy lloje: Ndonjëherë një thënie përdoret për të përcjellë një kuptim dhe qëllimi prapa saj është përcjellja e kuptimit të parë dhe të fjalëpërfjalshëm të fjalëve. Për shembull ne përdorim fjalën “mal” për t'iu drejtuar malit në kuptimin e tij të drejtpërdrejtë si kuptim, i cili është një lartësi e madhe natyrore e sipërfaqes së tokës. Gjithashtu ne përdorim fjalën “Hënë” për t'iu drejtuar satelitit natyror i cili rrethon Tokën dhe është e dukshme gjatë natës nga drita e pasqyruar. Ne përdorim fjalën “det” për t'iu drejtuar trupit të madh të ujit, detin të cilin ne e njohim të tërë dhe nëse pamë një luan në pyll, themi se ka një luan në pyll. Përdorimi i fjalëve mal, hënë, det dhe luan në shembujt e lartpërmendur ka për qëllim të tregojë përkufizimet themelore dhe origjinale të fjalëve. Ky lloj i përdorimit të gjuhës letrare quhet përdorimi i vërtetë i gjuhës dhe fjalët këtu quhen të vërteta.

Ndonjëherë kur ka një lidhje midis një përkufizimi dhe një tjetri, që do të thotë se ata ndajnë të njëjtat pikëpamje, një fjalë mund të përdoret në vend të një tjetre për të përcjellë kuptimin e vërtetë. Për shembull nëse përshkruani një njeri të fuqishëm elastik që e patë, ju mund të thoni se unë pashë një mal. Fjala këtu nuk i drejtohet një mali të pranishëm në kuptimin fjalë për fjalë, por më tepër një njeriu të fuqishëm dhe i qëndrueshëm si një “mal”. Siç mund ta shihni, ky përdorim është i vlefshëm në gjuhën e dytë. Sërish për shembull nëse pamë një njeri i cili nuk ka frikë, i guximshëm, i patrembur në beteja, mund të themi se ky njeri është si një “luan”. Nuk duam të themi se ai është një kafshë e egër, por e përdorim këtë fjalë pasi që ka një kuptim të përbashkët me atë të trimërisë dhe e kështu me radhë. Në këto raste ne nuk i përdorim këto fjalë për t'iu drejtuar përkufizimeve të tyre të mirëfillta, por për kuptime të tjera të cilat i ndajnë me fjalën tjetër. Lloji i përdorimit quhet gjuhësor dhe këto thënie quhen thënie metaforike. Pra ky lloj i përdorimit është i zakonshëm në të tëra gjuhët ashtu siç e dini të tërë.

Ia vlen që të përmendet dukuria se përdorimi i gjuhës zakonisht kuptohet në shqisat e saj të vërteta ose fjalë për fjalë. Pra nëse dikush do që të përcjellë një kuptim tjetër (metaforik), ai duhet të japë një shenjë ose një të dhënë për ta sqaruar atë.

Gjuha E Vërtetë Dhe Metaforike Në Kur'anin E Shenjtë

Hyrja e mëparshme duhet të merret si e mirëqenë kur bëhet fjalë për një tekst kuranor. Kur'ani Famëllartë u dërgua në gjuhën arabe, e cila ishte një ideal i standardit më të lartë të elokuencës dhe gjuhës së rrjedhshme, ku përdoret gjuha e vërtetë dhe ajo metaforike kështu që jo të tëra thëniet përcjellin kuptimet e tyre të drejtpërdrejta. Prandaj duhet të kihet kujdes. Për shembull kur e shikon këtë ajet: **“Por kush që ka qenë i verbër në këtë botë, do të jetë i verbër në botën tjetër dhe do të jetë i humbur më shumë nga udha e drejtë”** (Sure Isra, Ajeti 72) ne jemi të vetëdijshëm se fjala “i verbër” do të thotë një njeri i cili është i paaftë për të parë, qoftë që në lindje ose si pasojë e një aksidenti, nëse është fjala “i verbër” është përdorur në kuptimin e tij fjalë për fjalë; megjithatë kjo bie në kundërshtim me mençurinë dhe drejtësinë e Allahut, çfarë gabimi bëri ky njeri i verbër në këtë botë duke vuajtur nga verbëria që të ringjallet “i verbër” në Ditën e Gjykimit, “i verbër” dhe madje “i humbur”! Mënyra e saktë për të sqaruar këtë është të mendosh se fjala “i verbër” këtu përdoret në kuptimin metaforik, që do të thotë se një njeri i verbër ose “i verbër” në zemër; një njeri i cili ka humbur udhën dhe është shmangur nga udha e drejtë.

Rishtas kur lexojmë këtë ajet: **“Dora e Allahut është mbi duart e tyre”**. (Sure Fet'h, Ajeti 10) Ne jemi të vetëdijshëm dhe besojmë se Allahu nuk ka trup lëndor dhe nuk ka asgjë të ngjashme me Të. Ne e dimë se fjala “dorë” këtu nuk do të thotë një gjymtyrë. Pra e vetmja mënyrë e saktë për të kuptuar këtë ajet është duke e cilësuar se përdoret në kuptimin metaforik, pra fuqi ose forcë sepse sundimi portretizohet nga përdorimi i duarve. Arabishtja është një gjuhë e rrjedhshme e cila pranon një gamë të gjerë kuptimesh të ndryshme, dhe Kur'ani Fisniku dërgua në këtë gjuhë. Si rrjedhojë disa ajete duhet të interpretohen në kuptimin e vërtetë të tyre të fjalëpërfjalshëm dhe të tjera në një kuptim metaforik nëse ka një shenjë apo një të dhënë e cila tregon se pas këtyre hyrjeve, do të kthehemi në çështjen në fjalë, e cila është Ora dhe etapa përfundimtare dhe vendimtare, pas adresimit të mbretërisë së berzahut në kreun e parë.

Tregues Të Ringjalljes Së Fundit

E para dhe më e rëndësishmja është se koha kur do të vijë ora dihet vetëm nga Allahu, Ai është i Lartësuar, sepse është një çështje e fshehtë ose e padukshme (gajb) që Allahu e ruajti për Vetën e Tij. Allahu ua ka shfaqur disa të fshehta (gajbe) të dërguarve të Tij (p.m.t.) dhe ata më pas ua shfaqën popujve të tyre. Krahas kësaj Ai ruajti disa të fshehta tek Ai dhe nuk ua zbuloi asnjërit nga të dërguarit Tij (p.m.t.), kujdestarët e Tij apo engjëjt, të cilat përfshijnë kohën kur do të vijë Ora. Kështu askush nuk e di se kur do të vijë Ora - në një vit, njëqind vite, një mijë apo dhjetë mijë vite ... - dhe kjo do të ndodhë papritmas. Një nga cilësitë e saj të veçanta është se ajo do të ndodhë papritur. Sipas përcjelljeve kur ajo do të ndodhë, njerëzit do të jenë të zënë me jetën e tyre të përditshme dhe do t'i zihen në befasi dhe papritur.

Ky është një besim i vërtetuar qartë në Kur'anin e Shenjtë dhe përmendet nga Ehli Bejti (p.m.t.). Për më tepër ky besim përmendet në shumë ajete në Kur'anin Famëllartë duke përfshirë: **“Ata me siguri janë të humbur ata të cilët e mohojnë takimin me Allahun. Kur Ora do t'i zërë ata në befasi ata do të thonë: “Mjerë për ne për atë që kemi lënë pas dore në të!” Dhe ata do të mbajnë barrën e tyre në shpinë. Shikoni! E keqja është ajo që ata mbajnë”**. (Sure En'am, Ajeti 31), **“Ata iu pyesin në lidhje me Orën kur do të ndodhë?” Thuaj: “Dituria e saj është vetëm tek Zoti im; asnjë përveç Tij nuk do ta shfaqë atë në kohën e saj. Ajo do të peshojë rëndë në qiej dhe në tokë dhe nuk do t'iu zërë vetëm se në**

befasi. “Ata iu pyesin sikur të ishët në dijeni të saj”. Thuaj: “Dituria e tij është vetëm tek Allahu por shumica e njerëzve nuk e dinë”. (Sure Araf, Ajeti 187), “A nuk mendojnë se Ora mund t’i zërë ata në befasi kur nuk janë të vetëdijshëm?” (Sure Zuhruf, Ajeti 66)

Ndërsa për sa u përket përcjelljeve të përcjellura nga Ehli Bejti (p.m.t.) i dërguari i Allahut (p.q.m.t.) ka thënë: *“Në fund të kohës do të ketë shtrëngim si copa të një nate të errët dhe kur zemërimi i Allahut të Plotfuqishëm zbret mbi njerëzit e tokës, i Lartësuar është Ai, urdhëron Israfilin që të fryjë një goditje të tmerrshme dhe kështu ai fryn kur njerëzit janë të pavëmendshëm. Disa njerëz do të jenë në shtëpitë e tyre, disa në tregjet e tyre, disa në tokat e tyre të punueshme, disa në udhëtimet e tyre, disa duke ngrënë dhe do të vdesin para se të fusin një kafshatë në gojën e tyre, duke qenë të shtangur dhe të tronditur dhe disa flasin me shokët e tyre, por do të vdesin përpara se të përfundojnë bisedën e tyre”. (“Mealemu ’z-Zulfe fi’l-Mealemi’d-Dunja uel-Uhra” (Dituritë e Njohura në Këtë Botë dhe në Tjetrën), vëll. 4, Kreu 6, Hadithi Nr: 8) Gjithashtu është përmendur në veprën me titull: *“Tefsiru ’l-Kummi” (Komentimi i Kummit)* në lidhje me ajetin e mëposhtëm: *“Ata nuk janë duke pritur tjetër vetëm se një thirrje e cila i rrëmben ata kur janë duke u zënë mes vete”. (Sure Ja Sin, Ajeti 49) ai kumton: “(Allahu u përgjigjet): “Kjo do të ndodhë në fund të kohës. Një thirrje do të bëhet kur njerëzit do të jenë të zënë në tregjet e tyre. Të tërë vdesin në vendin e tyre dhe askush nuk kthehet në shtëpinë e tij as nuk bën siç do”. (“Tefsiru ’l-Kummi” (Komentimi i Kummit), Komenti i ajetit 49 të Sures Ja Sin). Gjithashtu autori i veprës me titull: *“Tefsiru ’l-Kummi” (Komentimi i Kummit)* lajmëron se: *“Kur të vijë Ora nëse dy njerëz po i shpalosin veshjet e tyre për shitje, ata nuk kanë mundësi t’i palosin ato përpara se të vijë Ora; një burrë nuk do të ketë mundësinë për të vënë ushqimin e tij në gojë përpara se të vijë Ora dhe një njeri i cili mbush tasin e tij për të furnizuar bagëtinë e tij me ujë, nuk do të ketë mundësi t’u japë ujë përpara se të vijë Ora”. (“Tefsiru ’l-Mizani” (Komenti i Peshores), Komenti i ajeteve 48-65 të Sures Ja Sin).***

Sidoqoftë cilat janë ngjarjet që do të ndodhin kur Allahu, i Lartësuar është Ai, do të lejojë që Ora të ndodhë?

Tekstet kuranore i përgjigjen kësaj pyetjeje dhe na vënë në dijeni se këto ngjarje ndodhin në dy shkallë. Disa ngjarje janë të lidhura me të tëra qeniet e gjalla duke përfshirë ne njerëzit. Ngjarje të tjera lidhen me trupat e pajetë të këtij universi natyror, si dielli, hëna, malet, deti, dhe gjëra të tjera si këto. Këtu ia vlen të përmendet se këndvështrimi i përgjithshëm mbizotërues i këtyre ngjarjeve është shpërndarja e emocioneve të frikës, terrorit, tronditjes, panikut dhe shqetësimit për fatin e dikujt. Këto emocione i shoqërojnë njerëzit që nga fillimi i ngjarjeve derisa të vendosen fatin e tyre nëse ata do të hyjnë në xhennet ose në xhehennem. Allahu në fillim të Sures HaxhXH thotë: *“O ju njerëz, ruajuni nga dënimi i Zotit juaj, sepse tërmeti i Orës është një llahtari e madhe. Atë ditë kur do ta përjetoni atë, çdo grua gjidhënëse do ta lërë atë që ka në gj dhe çdo grua shtatëzënë do ta dështojë para kohe barrën e saj, ndërsa njerëzit duken sikur janë të dehur por ata nuk janë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër”. (Sure HaxhXH, Ajetet 1-2)*

Gjendja E Qenieve Të Gjalla Në Ditën E Ringjalljes

Ne këtu do të flasim për llojin e parë të ngjarjeve të cilat kanë të bëjnë me qeniet e gjalla, duke përfshirë njerëzit. Kur’ani Fisnik na tregon se kur Allahu, i Lartësuar është Ai, do të lejojë që Ora të vijë, Ai urdhëron që të të tëra gjallesat do të vdesin, duke përfshirë njerëzit, xhinnët, engjëjt dhe kafshët. Askush në të tërë gjithësinë nuk do të mbetet i gjallë, përveç Allahut të

Plotfuqishëm, **“Çdo gjë që është në të (në tokë) është e përkohshme dhe do të mbetet vetëm fytyra e Zotit tënd i Cili është i madhëruar e i nderuar!”** (Sure Rrahman, Ajetet 26-27)

Ne nuk po flasim vetëm për qeniet në tokë, sepse e dimë se ka qenie të gjalla të cilat nuk jetojnë në tokë siç janë engjëjt. Disa gjenden në tokë dhe të tjerët janë në qiell. Ka edhe qenie të tjera si xhinnët të cilët banojnë në botën e tyre dhe që të të tërë do të goditen nga vdekja. Edhe të vdekurit të cilët jetojnë në botën e berzahut janë të përfshirë. Allahu, i Lartësuar është Ai, do të shkaktojë vdekjen e çdo qenieje të gjallë, qoftë ajo e banueshme në këtë botë të zakonshme, në berzah osenë botërat të tjera.

Si Do Të Shkaktojë Allahu Vdekjen E Tyre?

Në lidhje me këtë dukuri ajetet kuranore flasin për dy çështje. E para është britma, e cila përshkruhet si i fuqishme dhe mbretëruese dhe e cila do të dëgjohet nga çdo qenie e gjallë e cila është duke jetuar në atë çast, duke shkaktuar vdekjen e të tërëve. E dyta është suri (briri) duke iu drejtuar këtij ajeti kuranor: **“Dhe kur t’i fryhet surit (bririt) dhe do të bjerë e vdekur çfarë ka në qiej dhe në tokë, përveç atyre që do Allahu (që të mos vdesin), pastaj i fryhet atij për herën e dytë dhe të tërë ata do të ngrihen duke pritur e (urdhrin e Zotit)”**. (Sure Zumer, Ajeti 68)

Suri këtu nënkupton një bri. Kur u pyet për këtëi dërguari i Allahut (p.q.m.t.) shprehu: “Suri është një bri i cili do të bjerë”. Briri është një instrument i lashtë i cili u përdor përpara shpikjes së altoparlantëve. Ai përdorej nga ushtritë për të mbledhur trupat e shpërndara. Atij i bihej në mënyrë që të tërë ushtarët ta dëgjonin atë dhe menjëherë të mblidheshin në pikën e mbledhjes. Ai gjithashtu u përdor për të mbledhur banorët e një zone për të bërë një njoftim. Kështu briri është një instrument i njohur që kur Allahu krijoi Ademin deri disa vite më parë dhe madje disa njerëz përdorin atë deri në ditët tona. Megjithatë kjo do të thotë se - sipas disa përcjelljeve dhe thënieve - Israfilin i cili është një nga engjëjt më të shquar do të mbajë një bri dhe do t’i fryjë - duke vënë në dukje se askush nuk i di veçoritë, madhësinë ose tiparet fizike të bririt. Kështu zëri i cili do të dalë nga briri do të arrijë çdo qenie të gjallë dhe do të shkaktojë vdekjen e saj? Ky mund të jetë kuptimi i synuar, ose përmendja e bririt mund të jetë një thënie metaforike së cilës iu jemi drejtuar më lart.

Gjenden një numër i madh përcjelljesh të cilat adresojnë për tek kjo çështje. Sërish është përcjellur se Imam Ali Ibn Husejni (p.m.t.) ka thënë në lidhje me ngjarjet e Orës: **“Allahu urdhëron Israfilin kështu që ai zbret në tokë me një bri që ka një kokë dhe dy skaje dhe midis secilës fund ka një largësi (të barabartë) me atë midis qiellit dhe tokës. Ai i fryn atij dhe një zë del nga fundi i tij duke prekur njerëzit e tokës. Kështu që çdonjëri në tokë me shpirt do t’i bjerë të fikët dhe do të vdesë. Një zë tjetër do të dalë nga fundi duke prekur njerëzit e qiellit. Kështu që çdonjëri në qiell me shpirt do t’i bjerë të fikët dhe do të vdesë, përveç Israfilin dhe ata do të mbeten si të tillë derisa Allahu të dojë”**. (**“Mealemu’z-Zulfe fi’l-Mealemi’d-Dunja uel-Uhra”** (Dituritë e Njohura në Këtë Botë dhe në Tjetrën), vëll. 4, Kreu 6, Hadithi Nr: 1) Gjithashtu është përcjellur se i dërguari i Allahut (p.q.m.t.) ka thënë: **“Në fund të kohës, do të ketë shtrëngim si copa të një nate të errët, dhe kur zemërimi i Allahut të Plotfuqishëm do të zbresë mbi njerëzit e tokës, Allahu, i Lartësuar është Ai, urdhëron Israfilin për t’i fryrë një fryrje të tmerrshme dhe kështu ai e fryn atë kur njerëzit janë të pavëmendshëm”**. (**“Mealemu’z-Zulfe fi’l-Mealemi’d-Dunja uel-Uhra”** (Dituritë e Njohura në Këtë Botë dhe në Tjetrën), vëll. 4, Kreu 6, Hadithi Nr: 8) dhe ky rrëfim tregon qartë atë të cilën përmendet për mbledhjen e njerëzve siç u citua më lart dhe kuptimi i synuar

do të ishte britma të cilën Allahu do të krijojë me fuqinë e tij të madhe të plotë. Kjo përmendet dhe në disa përcjellje siç ka rrëfyer i dërguari i Allahut (p.q.m.t.). Ky i fundit ka thënë kështupër Ditën e Ringjalljes: **“Një britmë e vetme do të ndodhë tek njerëzit, kështu që çdo i vdekur do të ngrihet dhe çdo i gjallë do të vdesë përveç atij që Allahu do”.** (**“Mealemu ’z-Zulfe fi’l-Mealemi’d-Dunja uel-Uhra” (Dituritë e Njohura në Këtë Botë dhe në Tjetrën), vëll. 4, Kreu 6, Hadithi Nr: 2)**

Që të dyja mendimet janë të miratuara në mesin e dijetarëve por dëshmia e vërtetuar është përfundimi. Përfundimi është se ky zë i fuqishëm, i tmerrshëm dhe i zhurmshëm do të arrijë tek çdo mendje, zemër dhe shpirt, duke lënë të në gjendje tëfikëtitë tërë në qiej dhe në tokë në gjendje tëfikëti. “Tëfikëti” i përmendur në këtë ajet mund të jetë ose nuk mund të jetë vdekjeprurës ashtu siç thotë Allahu: **“Dhe kur t’i fryhet surit (bririt) dhe do të bjerë e vdekur çfarë ka në qiej dhe në tokë, përveç atyre që do Allahu (që të mos vdesin), pastaj i fryhet atij për herën e dytë dhe të tërë ata do të ngrihen duke pritur e (urdhrin e Zotit)”.** (**Sure Zumer, Ajeti 68**)

Disa komentues e kanë shqyrtuar nga afër këtë thënie: **“përveç atyre që do Allahu”**, duke pasur parasysh se disa prej krijimeve të Allahut do të përjashtohen nga vdekja e shkaktuar nga ky tëfikët. Megjithatë ata kanë ndasi mendimi në përcaktimin e tyre. Disa thonë se ata janë Xhibrili, Mikaili, Israfil dhe Israili. Të tjerë thonë se janë engjëjt e shquar. Sipas disa përcjelljeve të tjera ata janë dëshmorë. Pavarësisht kësaj ka komentues të tjerë të cilët thonë se kjo thënie u përmend për të shprehur fuqinë absolute të Allahut dhe në në të vërtetë, çdo qenie e gjallë në qiej dhe në tokë do t’i bjerë të fikët dhe do të vdesë pa përjashtim. Sidoqoftë çdo qenie e gjallë - përveç atyre të cilët janë përjashtuar sipas mendimit të parë - do të’u bjerë të fikët dhe do të vdesin dhe Allahu, i Lartësuar është Ai, do të jetë i Vetmi i gjallë.

Lidhur me - para ose pas kësaj ngjarjeje të parë e cila prek të tëra qeniet e gjalla janë të pranishme do të ndodhin dhe ngjarje të tjera, të cilat lidhen me sferën e qenies dhe universin. Në vijim do të përmendim një varg ajetesh kuranore të cilat flasin për këto ngjarje. Por ne do të nxjerrim një skicë të skenës, kështu që nuk do të jetë më e nevojshme që të interpretojmë ajetet, kuptimet e të cilave atëherë do të jenë të qarta për lexuesit kur të paraqiten.

Skena Kozmike E Ditës Së Ringjalljes

Çfarë Do Të Ndodhë Në Shkallën e Kozmosit?

Dielli -i cili burimi i dritës, nxehtësisë dhe i jetës në sistemin tonë diellor, përveç disa përfitimeve të cilat janë në të tërë gjithësinë tonë - do të marrin fund atë ditë. Kjo do të thotë se ai do të jetë i palosur, i mbuluar dhe drita e tij do të shuhet. Kur të asgjëohet hëna nuk do të ketë më dritë. Errësira do të përhapet mbi tokë. Çdo gjë në sistemin tonë diellor e cila mbështetet në dritën e diellit do të përfshihet së bashku me errësirën. Për sa i përket planeve dhe yjeve në hapësirë themi se ata do të shpërndahen, bien dhe do të shuhet. Kjo dukuri është shkencërisht e mundur. Ka diçka e cila quhet vdekja e yllit ose e planetit e cila mund të sqarohet disa nga dukuritë e mësipërme. Ndërsa qielli i cili është i ngritur mbi ne do të shqyhet dhe do të çahet tërësisht.

Malet do të shkërmoqen copë copë, do të shndërrohen në pluhur dhe do të bëhen si dunat e lëvizjes së rërës - që do të thotë se ata do të shpërndahen me erë si dunat e rërës - dhe do të bëhen menjëherë njësh me tokën. Për ta bërë këtë më të qartë përfytyroni një mal i cili bie. Çfarë terrori do ta linte ai incident në zemrat e njerëzve! Tanipërfytyroni se si do të ishte ai

terror sikur të tërë malet në tokë do të binin dhe do të shkërmoqeshin copë copë në një çast. Cila zemër dhe mendje do të mund ta duronte atë? Ndërsa për sa i përket tokës nënvizojmë se ajo do të tronditet, do të dridhet, do të hedhë barrën e saj dhe do të zgjerohet. Toka do të rrafshohet pa male, lugina, lartësi, ose vende të zbrazëta. Ajo do të jetë një sipërfaqe e sheshtë të zgjatur, sikur të ishte shtruar si shkretëtira e ringjalljes ku do të mblidhen miliarda qenie njerëzore dhe krijime të tjera. Më pas detet do të bëhen të turbullta do të shpërthejnë dhe do të kthehen në zjarr flakërues. Ujërat e tyre do të ndizen dhe do të zhduken. As detet, malet, luginat, pemët, as ndonjë shenjë jete nuk do të mbetet.

Çfarë Kuptojmë Ne Nga Këto Skena Kuranore?

Ajo që tregojnë këto ajete është se Allahu, i Lartësuar është Ai, nuk e asgjëson universin, por e rikrijon atë dhe rindërton atë në përputhje me një sistem të ri. Sa i përket ndryshimeve që ndikojnë në tokë, mund të pyesim nëse njerëzit do të mblidhen dhe do të marrin llogaritë e tyre - në Ditën e Ringjalljes - në errësirën e katranit, meqenëse nuk do të ketë më një diell, hënë apo yje në atë ditë. Përgjigjja është se Allahu i Plotfuqishëm do të krijojë dritë të drejtpërdrejtë në atë sistem të ri, dritë e cila do të shkëlqejë në të tëra gjallesat e ringjallura të mbledhura: ***“Toka do të ndriçojë me dritën e Zotit të saj”.*** (Sure Zumer, Ajeti 69)

Kështu në Ditën e Ringjalljes do të dëshmojmë një univers, gjithësi dhe një natyrë të re. Megjithatë ky univers do të jetë ende natyror me tokën, dritën dhe elementët e tjerë të natyrës. Më tej do të jemi të bëjmë me çështjen e xhennetit dhe xhehennemit. Dhe ashtu siç cituam kjo gjithësi e re do të ketë ligjet e saj të cilat ndryshojnë nga ligjet e fizikës, kimisë, biologjisë, mjekësisë, matematikës, astronomisë dhe ligjeve të tjera të universit tonë. Ky është një kozmos i ndryshëm me rendin, ligjet dhe pikëpamjet e tij, ndryshe nga ai që ne të tërë e dinim para ardhjes së orës. Allahu thotë: ***“Ditën kur toka u shndërrua në një tokë tjetër dhe në qiej dhe ato dalin sheshit përpara Allahut, Një të Gjithëfuqishmit”.*** (Sure Ibrahim, Ajeti 49) Ne do të dëshmojmë prodhimin, riformësimin ose riorganizimin i një toke të re dhe qiejve të rinj nga Allahu pas rënies dhe shkatërrimit të këtij universi.

Meditimi Bashkëkohor Si Dëshmi Kuranore

Pas dhënies së një pamjeje të përgjithshme të kushteve të universit në Ditën e Ringjalljes, ne do të paraqisim këtu disa dëshmi kuranore. Ne do t'i cilësojmë këto ajete kuranore me një sy meditues, duke shpresuar se do të ishte e dobishme pa hyrë në sqarime dhe imtësi të plota. Këto ajete përkundrazi do të shërbejnë si plotësuese për skenën e paraqitur më sipër.

Në Suren Uakia Allahu thotë kështu: ***“Kur toka do të dridhet me dridhje të fuqishme”.*** (Sure Uakia, Ajeti 4). Tani lexuesiduhet të përfytyrojë një tërmet të vogël dhe shtrirjen e panikut dhe frikës e cila do të shkaktonte një tërmet të thjeshtë në çdo zonë që zgjatë gjysmën e minutit duke shkaktuar shembjen e ndërtesave dhe krisja e tokës mund të lërë njerëzit në një tronditje të plotë. Pra si do të ishte sikur të kishte një tërmet i cili do të godiste të tërë tokën në të njëjtin çast? Si do të ishte skena?

Pikërisht ashtu siç thuhet në Suren Uakia: ***“Kur toka do të dridhet me dridhje të fuqishme dhe malet do të shkërmoqen copë copë dhe do të bëhen pluhur i shpërndarë”.*** (Sure Uakia, Ajetet 4-6)

Për më tepër në Suren Murselat Allahu kumton si më poshtë: ***“Nuk ka dyshim se ajo për të cilën iu është dhënë fjala do të ndodhë patjetër. Kur yjet të shuhen. Kur qielli të çahet hapet dhe kur malet do të shpërndahen si pluhur”.*** (Sure Murselat, Ajetet 7-10)

Më pas në Suren Hakka Allahu na bën të ditur si vijon: **“Kur t’i fryhet surit (bririt) me një shpërthim të vetëm”**. (Sure Hakka, Ajeti 13) E thënë ndryshe do të ketë vetëm një shpërthim të vetëm i cili do të mjaftojë për t’i shkaktuar vdekjen të tëra qenieve të gjalla. **“Dhe do të ngrihen toka dhe malet e t’i mëshojnë njëra-tjetrën me një të goditur. Në atë kohë do të ndodh e vërteta (kijameti). Dhe qielli do të çahet sepse ajo është një ditë e tmerrshme”**. (Sure Hakka, Ajetet 14-16) Ai nuk do të ndodhë në etapa sepse një numër tërmetesh do të ndodhin menjëherë. **“Dhe qielli do të çahet sepse ajo është një ditë e tmerrshme”**. (Sure Hakka, Ajeti 16) Por përse qielli do të çahet dhe bëhet i dobët? Kjo do të thotë që atmosfera e cila e mbron dhe e rrethon tokën nga rënia e trupave qiellore si kometat, yjet dhe asteroidet. Kjo hapësirë e tërë e jashtme do të çahet dhe të tëra tmerret të cilat përdoren për t’u shikuar në dokumentarët shkencorë do të ndodhin të tëramenjëherë.

Më tej në Suren Muzzemmil, Allahu, i Lartësuar është Ai citon kështu: **“Ditën kur toka dhe malet do të dridhen dhe malet do të bëhen si kodra me rërë rrëshqitëse”**. (Sure Muzzemmil, Ajeti 14)

Ndërsanë Suren Inshikak Allahu kumton si më poshtë: **“Kur qielli do të çahet, t’i bindet urdhërit të Zotit të tij ashtu siç i takon dhe kur toka do të shtrihet në gjerësinë e saj dhe do të nxjerrë çfarë ka brenda saj e të çlirohet”**. (Sure Inshikak, Sure 1-4)

Ndërsa në Suren Infitar Allahu përshkruan si vijon: **“E kur qiejt do të çahen, kur yjet do të shpërndahen, kur detrat do të trazohen dhe kur varret do të përmbysen”**. (Sure Infitar, Ajetet 1-4)

Ndërsa në lidhje me Suren Karia e cila që do të thotë ringjallje ose krisma e kijametit Allahu thotë: **“Krisma e kijametit. Çfarë është krisma? Kush të mësoi ty se çfarë është krisma? Ajo është dita kur njerëzit do të bëhen si tenja të shpërndara.** - Kjo do të thotë se ata do të ngatërrohen dhe do të humbasin. - **Dhe malet e ngurta do të kthehen në pluhur të butë. Kjo do të thotë se - veprat e atij të cilit peshojnë rëndë në peshore. Ai do të ketë një jetë të këndshme. Ndërsa veprat e atij të cilit peshojnë lehtë në peshore. Vendi i tij do të jetë në hauijje. Kush do të mësojë ty se çfarë është hauijje? Ai zjarri përvëlues”**. (Sure Karia, Ajetet 1-11)

Për më tepër në Suren Zelzele Allahu thotë: **“Kur do të dridhet toka me tërmetin e saj të fuqishëm.** - Kjo do të thotë se ky është tërmeti i vërtetë në krahasim me të tëra tërmetet që njohim nuk janë asgjë - **Dhe do të nxjerrë toka atë që ka brenda saj barrën nga brenda. Dhe njeriu do të thotë: “Çfarë janë këto që e shkaktojnë këtë tërmet?” Atë ditë ajo i rrëfen tregimet e veta. Sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë. Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në palë për të treguar shpërblehen për veprat e tyre”**. (Sure Zelzele, Ajetet 1-6)

Ndërsa në Suren Tekuir Allahu zbulon: **“Kur dielli të jetë çarë (dhe errësohet).** - Një nga ngjarjet më të rëndësishme të cilat do të ndodhin është kur dielli do të shtrihet dhe do të bëhet i pakalueshëm -. **Dhe kur yjet të kenë rënë (të jenë shpërndarë). Dhe kur malet e vendosura të lëvizin (të bërë pluhur në ajër). Dhe kur devetë shtatzënë të lihen pa bari në fushë. Dhe kur kafshët e egra të jenë mbledhur. Dhe kur detet të vlojnë si një zjarr flakërues. Dhe kur shpirtrat të jenë bashkuar. Dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura të gjalla. Se për çfarë mëkati janë vrarë. Dhe kur fletushkat e veprave të jenë shpalosur. Dhe kur qielli të jetë çarë.** - Së cilës mund t’i drejtohet atmosferës që përmendëm më lart -. **Dhe kur xhehennemi i ndezur të zbresë.** - **i cili përshkruan skenën e xhehennemit që do të fillojë të vlojë duke u përgatitur për marrjen e banorëve të tij Dhe kur xhenneti të jetë afruar.** - i cili gjithashtu

përgatitet për të mirëpritur banorët e mirë të tij -. ***Atëherë njeriu do të dijë se çfarë ka përgatitur për veten e tij (të mirë ose të keqe)***. (Surja Tekuir, Ajetet 1-14)

Pas këtyre ngjarjeve universale - të cilat të tëra ose disa ndodhin njëkohësisht - prania e qenieve të gjalla do të përfundojë dhe do të ketë një univers të ri. Vetëm Allahu e di sa kohë do të mbetemi në atë etapë përpara se Allahu të dojë të ringjallë dhe të rimbledhë të tëra krijimet dhe qeniet njerëzore për llogaritjen. Mund të duhen orë, ditë, disa vite apo mijëra vjet. Kjo është një nga çështjet e “gaibit” (e së fshehtës, së padukshmes panjohur), për të cilën flet Kur’ani i Shenjtë. Askush nuk mund të japë një përgjigje të caktuar në lidhje me këtë çështje, sepse krijimi i ringjalljes përfundimtare do të ndodhë vetëm kur Allahu i Plotfuqishëm do. Në të vërtetë, Kur’ani Famëlartë nuk e ka përmendur periudhën e kohës e cila do të kalojë mes të fryrjes së surit (bririt) e cila do të shkaktojë vdekjen e të tëra qenieve të gjalla dhe ringjalljen e tyre. Kjo është një nga çështjet të cilën e di vetëm Allahu. Krahas kësaj janë të pranishme përcjellje të përcjellura nga imamët e pagabueshëm, në të cilat ata i adresohen kësaj në mënyrë me dy kuptime pa përcaktuar periudhën kohore.

Rikthimi Në Jetë Dhe Ringjallja E Të Vdekurve

Në këtë etapë do të kthehemi duke folur për gjendjen e qenieve njerëzore atë ditë. Ne do të trajtojmë rrethanat e ringjalljes së tyre, pasi kemi trajtuar mbi etapën kur ata do të vdesin. Diskutimi mbi çështjen e ringjalljes ndahet në dy pjesë, lidhur me mënyrën se si do të vdesin. Pjesa e parë trajton britmën e fuqishme, të tmerrshme dhe të dëgjueshme cila do të fryhet për të ringjallur të gjithë të vdekurit dhe për t’i ngritur ata nga varret e tyre. Ndërsa për sa i përket të dytës ai i drejtohet fryrjes së bririt e cila është fryrja e dytë. Kjo fryrje do t’i sjellë të tërë të vdekurit në jetë dhe do t’i ringjallë ata nga varret e tyre. Kjo është fryrja e ringjalljes dhe ringjalljes.

Për më tepër shihni përcjelljet e përmendura në shënimet e fundit të mëparshme. Lloji i përcjelljeve dhe haditheve të cilat flasin për fryrjen e surit (bririt) nga Israfili, si një mjet për t’i shkatuar vdekjen e qenieve të gjalla, sërish përmendin një fryrje të dytë e cila do t’i sillte ringjallte këto gjallesa. Rishtas britma i adresohet një mjet i cili shërben për të shkatuar vdekjen e tyre dhe për t’i ringjallur ato qenie.

Allahu, i Lartësuar është Ai, thotë kështu në Librin e Tij të shenjtë: ***“Dhe kur t’i fryhet surit (bririt) ja atje do të jenë duke u përpjekur të shkojnë te Zoti i tyre nga varret e tyre”***. (Sure Ja Sin, Ajeti 51)

Një njeri mund të përfytyrojë skenën e tokës të mbingarkuar me varreza - varre të atyre të cilët janë shtrirë atje më përpara dhe atyre të cilët vdiqën dhe u varrosën si pasojë e shkatërrimit të planeteve, yjeve dhe maleve, si dhe tërmete - të tërë do të jenë duke pushuar brenda tokës! Përfytyroni se si do të jetë skena kur ata të kthehen në jetë, pasi trupat e tyre ripërtërihen, ringjallen dhe do të rikthehen në jetë duke marrë shpirtrat e tyre. Varret do të hapen dhe njerëzit do të zvarriten - miliarda njerëz në një çast do të përshkojnë udhën e tyre jashtë varreve të tyre me çudi dhe me terror.

Kjo ka shumë gjasa dhe është tërësisht e mundshme ashtu siç ndodhi në një kohë të mëparshme. Rrëfëhet se i dërguari Isa (Jezusi p.m.t.)kaloi një ditë pranë një varri dhe i kërkoi Allahut të Plotfuqishëm që të ringjallë të vdekurin i cili gjendej brenda. Allahu i dha leje atij dhe ai e thirri njeriun e vdekur. Kështu varri u hap dhe i vdekuri u ngrit nga varri i tij, i zbehtë, i tmerruar dhe i frikësuar. Isai (p.m.t.) e pyeti për ringjalljen dhe flokët e tij u

shndërruan të thinjura. I riu tha se ringjallja kishte ndodhur menjëherë sepse mendoi se kjo ishte Dita e Ringjalljes. Me fjalë të tjera vetëm mendimi se ringjallja kishte ndodhur ia shndërroi flokët të thinjura, pra mendoni se çfarë do të ndodhë në Ditën e vërtetë të Ringjalljes.

Allahu thotë: **“Dhe kur t’i fryhet surit (bririt) ja atje do të jenë duke u përpjekur të shkojnë te Zoti i tyre nga varret e tyre”.** (Sure Ja Sin, Ajeti 51) Kjo do të thotë se ata do të nxitojnë nga varret e tyre drejt vendit ku do të mblidhen para Zotit të tyre. thuj: **“Të mjerët ne! Kush na ngriti nga vendi ynë i gjumit ku ishim shtrirë në varre?” Kjo është ajo për të cilën na dha fjalën dhe na vërtetoi i Gjithmëshirshmit dhe të dërguarit**. (Sure Ja Sin, Ajeti 52) Ky ajet tregon se ata do të jenë në dijeni të rëndësishme së gjendjes. Lajmëtarët dhe të dërguarit (p.q.m.t.) i kishin paralajmëruar ata, mirëpo ata nuk besonin dhe ishin të pavëmendshëm.

“Kjo do të jetë një britmë e vetme dhe të tërë do të paraqiten para nesh!” (Sure Ja Sin, Ajeti 52) Kjo pasqyron madhësinë e Allahut, i lartësuar është Ai. Nëse duam të mbledhim disa mijëra njerëz, për shembull, çfarë çrregullimi do të shkaktohej! Nëse një vend do që të zhvillojë një ecje me miliona njerëz, atëherë të tëra forcat e saj do të duhet të punonin për zhvillimin e kësaj ecjeje dhe për parandalimin e trazirave. Pavarësisht kësaj Allahu i Plotfuqishëm në një britmë të vetme mbledh me miliarda njerëz dhe madje edhe më shumë - vetëm Ai e di se sa shumë do të jenë - në shkretëtirën e ringjalljes.

Në një ajet tjetër Allahu thotë: **“Ditën kur toka do të çahet për shkatërrimin e tyre, ata do të dalin duke u ngutur (për vendin e mbledhjes), e ajo është një mbledhje e lehtë për Ne”.** (Sure Kaf, Ajeti 44) Ata do të dalin nga varret e tyre duke u ngutur në atë vendin mbledhjes dhe gjithçka që do të jetë e lehtë për Allahun për të kryer.

“Ditën kur do të dëgjojnë britmën për të vërtetën (ringjalljen) dhe ajo është dita e ngritjes (nga varrezat)”. (Sure Kaf, Ajeti 42) Kjo është koha kur turmat do të ngrihen nga varret e tyre për t’u përballur me llogarinë dhe gjykimin para Allahut, i lartësuar është Ai. Ata do të dalin nga varrezat e tyre pa qefinë - përveç përjashtimeve të përmendura në përcjelljet e sipërcituara - këmbëzbathur dhe lakuriq. Duke përfshirë dhe këtë përcjellje të rrëfyer në veprën me titull: **“Tefsiru’l-Kummi” (Komentimi i Kummit)**: “Imam Aliu (p.m.t.) ka pyetur të dërguarin e Allahut (p.q.m.t.) për komentimin e thënies së Allahut: **“Ditën kur do t’i mbledhim të përkushtuarit tek i Gjithmëshirshmi si miqtë e ftuar”.** (Sure Merjem, Ajeti 85) Kështu që i dërguari i Allahut (p.q.m.t.) u përgjigj: **“O Ali kjo palë do të jetë vetëm në rritje. Ata janë njerëz të cilët e kishin frikë Allahun, kështu që Allahu i deshi ata, i veçoi ato dhe i pranoi veprat e tyre, dhe kështu i quajti ata të gjithmëshirshëm”.** Më pas ai tha: **“O Ali me të vërtetë betohem në Atë të Cilin krijoi farën dhe zuri fill frymën (e jetës), ata do të dalin nga varret e tyre me fytyra të bardha si bora, duke veshur veshje të bardha si qumështi dhe shuajt e këmbëve të praruara dhe me lidhëse me margaritarë të ndriçuar”.** (**“Tefsiru’l-Kummi” (Komentimi i Kummit, Komentimi i Ajetit 85 të Sures Merjem)**). Gjithashtu është përcjellur raportohet se Imam Kadhimi (p.m.t.) ka kumtuar: **“Ndjekësi ynë nuk do të largohet nga kjo botë (e zakonshme) pa qenë i kënaqur me Allahun, të Dërguarin e Tij dhe ne duke qenë të kënaqur me të. Allahu do ta mbledhë (ringjallë) atë me të tëra mëkatet e tij, me një fytyrë të zbardhur dhe me organe gjenitale të mbuluara. Ai nuk do të ketë frikë, as nuk do të shqetësohet”.** (**“Mealemu’z-Zulfe fi’l-Mealemi’d-Dunja uel-Uhra” (Dituritë e Njohura në Këtë Botë dhe në Tjetrën), vëll. 4, Kreu 15, Hadithi Nr: 4).**

Imam Ali Zejnulabdiddini (p.m.t.) në një lutje përshkruan gjendjen e një qenieje njerëzore atë ditë: **“Unë shoh një herë në të djathtë dhe një herë në të majtë dhe zbuloj se njerëzit sot kanë një shqetësim tjetër përveç timit”**. Një fragment nga lutja e Ebu Hamza Thumalit që është lutja e cila iu është veshur Imam Ali Zejnulabdiddinit (p.m.t.) dhe e cila është përcjellur në shumicën e librave të lutjeve. Askush në këtë ditë nuk sheh një njeri tjetër ose kujdeset për një njeri tjetër. Çdo njeri do të merret vetëm me veten në një gjendje paniku dhe frike, duke u shqetësuar për fatin dhe të ardhmen e tij. Çdo njeri do të jetë i shqetësuar për pyetjet dhe gjykimin e tij kur ata do të qëndrojnë para Allahut dhe të tërë do të qëndrojnë për një kohë kaq të gjatë përpara Tij. Kur’ani Fisnik gjithashtu përshkruan gjendjen e njerëzve atë ditë siç thuhet: **“Ti tërhiqju atyre vërejtjen për Ditën e Kijametit kur zemrat e mllfosura do të arrijnë në fyt”**. (Sure Gafir, Ajeti 18)

Ndërsa në një ajet tjetër thuhet: **“Dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat i arritën në fyt”**. (Sure Ahzab, Ajeti 10) në të cilën përshkrimi i fikës është më i rrjedhshëm në arabisht. Kur zemra do të arrijë në fyt nuk do të mund të flasë ose të marrë frymë pa lejen e Allahut. Heshtja dhe tmerrri do të mbizotërojnë. Ata do të qëndrojnë atje për një kohë shumë të gjatë. Ne nuk e dimë se sa gjatë do të jetë ajo ditë, sepse sistemi i tokës dhe koha do të ndryshojë. Kështu një ditë atëherë nuk do të jetë e barabartë me një ditë dhe kjo vlen edhe për vitet siç thuhet në Kur’anin e Shenjtë. Ata do të qëndrojnë në pritje derisa Allahu, i Lartësuar është Ai, urdhëron fillimin e marrjes në pyetje dhe në llogari të tyre.

Qëndrimi Përpara Allahut Për Gjykim

Askush nuk e di se sa e gjatë do të jetë koha midis mbledhjes së njerëzve në shkretëtirën e ringjalljes, sepse ata do të qëndrojnë lakuriq, këmbëzbathur, të zhytur në djersë, të tmerruar, të vuajtur nga uria dhe etja dhe më pas do të nisë fillimi i gjykimit dhe i marrjes në pyetje. Kjo është arsyeja pse Dita e Ringjalljes quhet edhe dita e urisë së madhe, dita e etjes së madhe dhe dita e terrorit të madh. I dërguari i Allahut (p.q.m.t.) vazhdimisht na ka kërkuar që të kujtojmë veten tonë për këtë ditë. Në fjalimin e tij të mirënjohur që ai dha duke përshëndetur Muajin e Ramazanit ai ka sqaruar: **“Me etjen dhe urinë tuaj mbani mend urinë dhe etjen e Ditës së Ringjalljes”**.

Pas kësaj kohe do të vijë koha e gjykimit në çastin kur Allahu do. Sipas thënies kuranore do të vendosen peshoret. Asgjë e cila nuk është përmendur në fillim të këtij kreu, përmendja e shkallëve nuk është dhënë në kuptimin e tij të mirëfilltë. Kuptimi i synuar është vendosja e drejtpeshimeve dhe masave. Rimat në poezi në arabisht përshkruhen si “shkallët e poezisë” dhe fjala “shkallë” gjithashtu përdoret për t’iu drejtuar mendjes e cila “peshon, dallon dhe veçon të drejtën nga e gabuara”.

Si rrjedhojë kur flasim për shkallët e veprave, kjo nuk do të thotë se veprat kanë peshë lëndore ose sasiore. Komentuesit kanë sqaruar se kuptimi i synuar është metaforik, që do të thotë se njerëzit do të merren në pyetje për veprat e tyre dhe këto vepra do të peshohen duke u mbështetur në peshoren e të mirës dhe të keqes. Kështu ata veprat e të cilëve peshojnë rëndë në peshore, janë ata të cilët kryen shumë vepra të mira dhe sa më të mëdha janë ato vepra, kjo do të thotë se aq të mëdhenj dhe të përkushtuar janë ndaj Allahut dhe ata të cilët janë pa vëlla, at, fëmijë apo miqtë e tij. E kundërta vlen për ata veprat e të cilëve peshojnë lehtë në peshore. Më tej do të fillojë marrja në pyetje dhe gjykimi. Do të ndahet në dy klasa, gjykimi i njerëzve dhe gjykimi i kombeve dhe i palëve. Për të dhëna të mëtejshme mbi çështjen e gjykimit të kombeve dhe palëve, drejtohu veprës me titull: **“Medresetu ’l-Kur’anit**

(Shkolla e Kur'anit) nga dëshmori Sejjid Muhammed Bakir Sadri. Këtu do të shqyrtojmë gjykimin e njerëzve.

Në lidhje me gjendjen e njerëzve në Ditën e Ringjalljes Allahu thotë kështu: ***“Dhe secili nga ata do të vijë i vetëm tek Ai në Ditën e Ringjalljes”.*** (Sure Merjem, Ajeti 95)

Çdo njeri do të jetë i zënë me veten etij dhe secili nga ne do të qëndrojë i vetëm për gjykim përpara Allahut të Plotfuqishëm dhe para të tëra qenieve të gjalla, përfshirë të dërguarve, engjëjve dhe të tërë njerëzve të cilët kanë jetuar që nga Ademi deri tek Ora e Ringjalljes. Të tërë do të jenë dëshmitarë të secilit nga gjykimet tona. Për këtë arsye shumë lutje përfshijnë thënie të cilat i luten dhe i përgjërohen Allahut për të fshehur gabimet tona në Ditën e Ringjalljes -me qëllim që të mos na i zbulojë atë ditë përpara të tërë atyre dëshmitarëve, sepse ne kemi kryer në këtë botë ato gjëra të cilatdo të na turpërojnë pa marrë parasysh zbulimin dhe do t'i nënshtrohen në Ditën e Ringjalljes. Një njeri kryen mëkatet në këtë botë në fshehtësi, duke patur frikë se familja e tij, fqinjët, anëtarët e sektit ose të partisë së tij, ose banorët e vendit të tij do ta gjykojnë atë. Pavarësisht kësaj në Ditën e Ringjalljes, veprimet e tij do të zbulohen para të tërë njerëzve që nga Ademi. Kështu cilido që kujdeset për nderin e tij do të kujdeset për të mos kryer ndonjë keqbërje apo mëkat që do ta zbulonte në atë ditë.

Kur një njeri do të përballet me gjykimin e tij do të paraqitet libri i veprave të tij. Ai do të urdhërohet që të shikojë këtë libër. Ai do të gjejë gjithçka që ai ka bërë gjatë tërë jetës së tij. Ky libër nuk do të lërë pa shënuar asgjë të vogël ose vepërtë madhe. Të tërë do të merren në llogari disa do të pyesin për ata të cilët kanë jetuar për njëqind apo dyqind vite, ose ata të cilët kanë jetuar për më shumë se një mijë vite në kohët e lashta - se sa i madh do të jetë shënimi i veprave të tyre? Në të kaluarën njerëzit do të pyesin dhe pastaj do të thonë se vetëm Allahu do ta dinte. Megjithatë njerëzimi në kohët bashkëkohore ka shpikur forma të teknologjisë e cila na lejon që t'i kuptojmë dhe t'u përgjigjemi pyetjeve të tilla. Tani secili nga ne mund të mbajë në dorë një pajisje të vogël, jo më të madhe se pëllëmba e dorës, mijra e madje dhjetra mijra libra. Libri i veprave tona mund të jetë ndoshta një lloj skene e cila do të luajë skena nga jeta jonë. Kjo është e mundur por vetëm Allahu e di.

Kur njeriu lexon librin e paraqitur atij, ai do të humbasë të tëra gjasat e mohimit. Në gjykimin e dhënë në këtë botë për shembull, një njeri mund të gënjejë, të fallsifikojë, të japë sqarime të rreme mbi qëndrimin e tij dhe të paraqisë dëshmi të fallsifikuara të cilat do të ndryshonin pikëpamjen e gjyqtarit për këtë çështje. Megjithatë ai do të jetë i dobët në Ditën e Ringjalljes, sepse gjithçka do të shënohet në librin i cili iu është paraqitur atij. Të dërguarit, engjëjt dhe të tërë njerëzit në tokë do të shërbejnë gjithashtu si dëshmitarë. Madje do të dëshmojnë dhe muret dhe shtëpitë ku janë kryer mëkatet. Gjuha, duart dhe këmbët e njeriut do të dëshmojnë kundër tij. Nuk ka shmangie!

Pra kush është gjykatësi në atë ditë? Ai është Allahu, Një dhe i Vetmi. Ai gjykon me drejtësi të plotë dhe nuk i bën padrejtësi askujt. Kur'ani Famëlartë thotë: “Sot nuk do të ketë padrejtësi” në duart e drejtësisë së plotë. Nuk do të ketë përkrahje, sepse Allahu, i Lartësuar është Ai, nuk ka frikë askush. Ai është i drejtë, i pasur (nuk ka asnjë nevojë), i gjithëfuqishmi dhe i gjithëdijshëm. Dituria e Allahut përfshin të tëra hollësitë më të vogla të kushteve të të tëra gjallesave, sepse Ai është Krijuesi i tyre. Pra si mund të shmanget?

Këtu në këtë botë ju mund të paguani një avokat për t'iu mbrojtur por atje nuk do të mundeni. Nuk do të keni avokat për t'iu mbrojtur dhe ju duhet të mbronin veten tuaj sepse të tëra dëshmitë do të zbulohen para jush. Allahu në librin e Tij thotë kështu: ***“Dita do të vijë kur***

çdo shpirt do të vijë duke u lutur për veten e tij dhe çdo njeri do t'i plotësohet ajo që meritoi dhe nuk u bëhet padrejtësi". (Sure Nahl, Ajeti 111)

Si rrjedhojë përfundimi do të jetë në dritën e gjykimit, librit të veprave, pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna. Gjykimi do të jetë vendimtar. Ata veprat e mira të të cilave peshojnë rëndë në peshore do të hyjnë në xhennet dhe ata veprat e mira të të cilëve peshojnë lehtë në peshore, ose nuk kanë bërë ndonjë të mirë do të hidhen në xhehennem. Gjendja nuk është e ndërlikuar. Nuk do të ketë nevojë për një libër të të drejtave në atë botë. Allahu shpall: ***"Veprat e atij të cilit peshojnë rëndë në peshore. Ai do të ketë një jetë të këndshme. Ndërsa veprat e atij të cilit peshojnë lehtë në peshore. Vendi i tij do të jetë në hauijje. Kush do të mësojë ty se çfarë është hauijje? Ai zjarri përvëlues". (Sure Karia, Ajetet 6-11)***

Pas kësaj do të shpërndahen çertifikatat dhe librat e njerëzve. Ata të cilët morën librin e tyre në dorën e tyre të djathtë do të jenë të hyjnë në xhennet, ndërsa ata të cilët morën librin e tyre të veprave në dorën e tyre të majtë ose pas shpinës do të dënohen në xhehennem. Pas ose para se të merret vendimi, ashtu si në gjykimet gjyqësore në këtë botë, i pandehuri i cili gjykohet do të përpiqet të gjejë zgjidhje, mundësi të tjera ose diçka që do ta shpëtojë nga kjo fatkeqësi. Të tëra kët dëshmi pohojnë se përvojat e njerëzve janë adresuar në Kur'anin Fisnik. Kjo nuk është një çështje ndjese ose keqardhjeje. Rrëfimi, kërkimi i ndjesës ose shprehja e keqardhjes nuk do të kenë asnjë dobi. Nuk ka asgjë që do t'i garantojë atij një rrugëdalje nga dënimi i tij - si në gjykata kur i pandehuri lejohet të lirohet me kusht. Megjithatë në atë ditë nëse ai do të jepte peshën e tërë tokës në ar ajo nuk do të pranohej.

Allahu i Plotfuqishëm thotë: ***"Ditën kur as pasuria, as fëmijët nuk do të bëjnë dobi, përveç atij i cili vjen me zemër të pastër për Allahun". (Sure Shuara, Ajetet 88-89)*** Prandaj pasuria e një njeriu ose fëmijët e tij nuk do të kenë asnjë dobi në atë ditë - përveç dëshmorëve çështje e cila është hqyrtuar në kreun e ndërmjetësimit. ***"Ditën kur një mik nuk do t'i bëjë dobi asnjë miku dhe as nuk do të ndihmohet". (Sure Duhan, Ajeti 41)***, kështu që i pasuri, sheiku ose udhëheqësi nuk do ta ndihmojnë atë. Allahu, i Lartësuar është Ai, thotë: ***"Ditën kur një njeri do t'i shmanget vëllait të tij, nënës së tij dhe të atit të tij, bashkëshortes së tij dhe bijve të tij, të cilët janë më të dashurit e tij. Secili njeri do të jetë i zënë me çështjen e tij". (Sure Abese, Ajetet 34-37)***

E thënë ndryshe atij nuk do t'i bëjë dobi as vëllai, nëna, i ati, bashkëshortja dhe as pasardhësi. Si pasojë e terrorit ai do të dëshmojë atje keqbërësi do të donte që ai të kursente veten nga dënimi i asaj dite. ***"Ndonëse ata shihen mes tyre (edhe njihen por i shmangen njëri-tjetrit). Keqbërësi do të kishte paguar dënimin e asaj dite me bijtë e tij dhe me bashkëshorten e tij dhe me vëllain e tij dhe me të afërmit e tij tek të cilët mbështetej. - Sepse do të jetë i gatshëm që të flijojë veten për të mbrojtur fëmijët e tij nga rreziqet dhe kërcënimet - fqinjët, partinë, qeverinë dhe ushtrinë e tij - dhe të tërë ata të cilët janë mbi tokë nëse kjo do ta kishte shpëtuar atë. Pastaj ai do të marrë përgjigjen e Allahut: "Kurrën e kurrës! Në të vërtetë ajo është një ledhdha (një zjarr flakërues) i cili heq kapakët e kokës". (Sure Mearixh, Ajetet 11-16)*** Pra ai është xhehennemi i cili pret keqbërësit, dhunuesit, dhe shtypësit të cilët nuk do të mund të shpëtojnë kurrë. Kështu atij nuk do t'i bëjnë dobi as pasuria, as fëmijët, as thesari, as farefisi dhe as shoqëruesi. Asgjë dhe askush nuk do të mund të ndihmojë. Rrëfimi, kërkimi i ndjesës ose shprehja e keqardhjes nuk do të kenë asnjë dobi. Asnjëra nga këto nuk do të ndihmojnë atë për të thënë: ***"Zoti im! Kthemë përsëri në jetë!" (Sure Muminun, Ajeti 99)*** - në këtë jetë - pasi bota ka marrë fund dhe toka dhe qiejt kanë ndryshuar rrënjësisht.

Kush Do Të Shpërblehet Në Atë Ditë?

E vetmja garanci dhe e vetmja gjë e dobishme është besimi dhe veprat e mira. Prandaj komandanti i Imam Aliut besimtar (p.q.m.t.) ka thënë: *“Allahu iu mëshiroftë! Përgatituni për udhëtim sepse thirrja për nisje është shpallur”*. Në të vërtetë furnizimi më i mirë është frika (e Allahut) (përkushtimi) dhe përkushtimi është prodhim i besimit dhe i veprave të mira.

Dukuria që u cek këtu është e mbështetur në hadithin e Imam Aliut (p.m.t.) të përcjellur në veprën e tij me titull: *“Nehxhu'l-Balaga” (Mjeshtri i Oratorisë)*: *“Allahu iu mëshiroftë! Përgatituni për udhëtim sepse thirrja për nisje është shpallur. Quajeni qëndrimin tuaj në botë si shumë të shkurtër dhe kthehuni tek Allahu me furnizimin më të mirë që është me ju, sepse me siguri para jush shtrihet një luginë, e cila është e vështirë për t'u ngjitur dhe vendet e qëndrimit janë të mbushura me frikë dhe rreziqe. Ju duhet të arrini atje dhe të qëndroni në ta. Dhe dijeni se sytë e vdekjes po iu afrohen drejt jush. Madje është sikur ju (tanimë) jeni në shpellat e saj dhe ajo e ka goditur veten kundër jush. Çështjet e vështira dhe rreziqet shqetësuese ju kanë shtypur në të. Prandaj duhet t'i asgjësoni të tëra lidhjet e kësaj bote dhe të ndihmoni veten tuaj me furnizimin e frikës së Allahut”. Shikoni: “Nehxhu'l-Balaga” (Mjeshtri i Oratorisë), Hutbeja Nr: 204.*

Pohojmë se përkufizimi i veprave të mira është shumë i gjerë. Ai përfshin vepra adhurimi, xihadi, sjellje të mira, vepra bamirësie, duke u dhënë ndihmë atyre të cilët janë në nevojë, duke mbrojtur njerëzit dhe duke mbrojtur nderin e tyre. Të gjitha këto vepra janë përcaktuar si vepra të mira dhe janë prodhimi i besimit, të cilat janë e vetmja gjë e dobishme në Ditën e Ringjalljes. Megjithatë Allahu i ka lënë një derë të hapur dhe shpëtimit dhe kjo është dera e ndërmjetësimit. Ndërmjetësimi i të dërguarve, lajmëtarëve, kujdestarëve të Allahut dhe dëshmorëve. Ndonëse askush nuk mund të garantojë dhënien e ndërmjetësimit ajo është ende një nga dyert e shpresës. Koncepti i ndërmjetësimit trajtohet në përcjelljet dhe ajetet kuranore. Për më tepër vërtetuar se dëshmorët ndërmjetësojnë për prindërit dhe familjet e tyre.

Gjithashtu në përcjellje është përcaktuar se i dërguari Muhammed (p.q.m.t.) ka bërë të ditur: *“Mua më janë dhënë pesë gjëra të cilët nuk u janë dhënë askujt tjetër para meje. Toka është bërë vend i sexhdes (përruljes në tokë) dhe një mjet pastrimi për mua; plaçka e luftës është lejuar për mua; Unë jam pajisur me shkaktimin e frikës (mbjelljen e frikës në zemrat e armiqve të mi); mua më është dhënë (dhuratën) e fjala lakonike (e prerë dhe e saktë) dhe mua më është dhënë (fuqia ose leja) ndërmjetësimit”*. Sërisht Muhammedi (p.q.m.t.) ka shpalosur: *“Unë kam qenë i favorizuar mbi të dërguarit e tjerë. Çdo i dërguar ka bërë një lutje (për Allahun) për popullin e tij, por unë e kam shtyrë lutjen time për bashkësinë time kështu që unë do të ndërmjetësoj për ta në Ditën e Ringjalljes. Kur unë do të qëndroj në vendin tim madhështor unë do të ndërmjetësoj tek Allahu dhe Ai do të pranojë ndërmjetësimin tim për ta”*.

Rishtas shtojmë se gjenden një numër i madh përcjelljesh të tjera të cilat vërtetojnë se i dërguari i Allahut (p.q.m.t.) zotëron autoritetin për të ndërmjetësuar.

b. Imamët e pagabueshëm dhe pjesa tjetër e të dërguarve (p.m.t.); Imam Sadiku (p.m.t.) ka thënë: *“Asnjë lajmëtar ose i dërguar i Allahut nuk do të ndërmjetësojë në Ditën e Ringjalljes derisa Allahu t'u japë leje, përveç të dërguarit të Allahut (Muhammedit (p.q.m.t.)), sepse Allahu me të vërtetë e ka lejuar atë që të ndërmjetësojë para Dita e Ringjalljes. Kështu, ndërmjetësimi është për atë dhe imamët e pasardhësve të tij (p.m.t.)*

dhe pastaj për të dërguarit, përshëndetja dhe paqja e Allahut qofshin mbi të tërë ata". Një përcjellje tjetër tregon se Imam Bakiri dhe Imam Sadiku (p.m.t.) kanë thënë: **"Betohemi në Allahun, se ne do të ndërmjetësojmë për mëkatarët e shiitëve (ndjekësve)"** duke përfshirë dhe përcjellje të tjera.

c. Një palë e besimtarëve besnikë, duke përfshirë dijetarë dhe dëshmorë; është përcjellur se i dërguari i Allahut (p.q.m.t.) ka thënë: **"Ai i cili i ndihmon kërkuesit e dijes, i do të dërguarit dhe do të jetë me ta dhe ai që i urren kërkuesit e dijes, i urren të dërguarit dhe do të jetë i dënuar në xhehenem. Në të vërtetë kërkuesit e dijes do të kenë (fuqinë) që të ndërmjetësojnë si të dërguarit"**. Në një përcjellje tjetër Imam Sadiku (p.m.t.) thotë: **"O Fadil mos u largo nga të varfërit tonë shiitë; në të vërtetë të varfërit e tyre do të ndërmjetësojnë në Ditën e Ringjalljes (për shumë njerëz)"**. Ajjashi ka rrëfyer nga Ubejd Ibn Zurare se Imam Sadiku (p.m.t.) është pyetur nëse besimtarët besnikë kanë aftësinë për të ndërmjetësuar? Ai (p.m.t.) u përgjigj: "Po". Gjithashtu thuhet se Imam Ebu Xhafer Bakiri (p.m.t.) ka thënë: **"I dërguari i Allahut (p.q.m.t.) do të ndërmjetësojë për popullin e tij, ne do të ndërmjetësojmë për shiitët tonë dhe shiitët tonë do të ndërmjetësojnë për familjet e tyre"**.

ç. Kur'ani i Shenjtë; është përcjellur se Imam Sadiku (p.m.t.) ka thënë: **"Ai i cili e lexon Kur'anin kur është një besimtar i ri, Kur'ani do të bashkohet me mishin dhe gjakun e tij ... dhe Kur'ani do ta mbrojë atë në Ditën e Ringjalljes"** duke përfshirë transmetime të tjera.

Theksojmë se përcjelljet e mësipërme duke përfshirë dhe të tjera që kanë të bëjnë me çështjen e ndërmjetësimit janë të shënuara të tëra në veprën me titull: **"Mealemu'z-Zulfe fi'l-Mealemi'd-Dunja uel-Uhra" (Dituritë e Njohura në Këtë Botë dhe në Tjetrën), vëll. 4, Krerët 23-29)**.

Me fjalë të tjera këta janë të dërguarit, imamët e pagabueshëm, kujdestarët e përkushtuar të Allahut (p.m.t.) dhe të tjerët të cilët Allahu dodo të ndërmjetësojnë për disa njerëz. Ata do të ndërmjetësojnë për të tjerët si pasojë e vendeve dhe shkallëve të tyre të larta dhe afrimitetit tek Allahu sepse Ai është më Bujari dhe më i Larti. Kështu disa njerëz do të shpëtojnë nga xhehennemi dhe nga vuajtja e saj. Megjithatë kjo do të bëhet sipas sistemit të ri të botës, i cili ka kufizimet dhe përcaktimet e tij të cilat u takojnë dhe të dërguarve dhe dëshmorëve. Ndërmjetësimi do t'u jepet vetëm disa palëve të caktuara të njerëzve sepse Allahu nuk pranon ndërmjetësimin për të tërë njerëzit.

Pavarësisht kësaj pohojmë se gjendet dhe një derë tjetër e cil të çon në shpëtim e cila është dera e mëshirës së Allahut. Allahu është Mëshirues dhe i Dashur. Mëshira e Tij përfshin zemërimin e Tij. Ai mund t'i falë njerëzit të cilët janë të dënuar në xhehennem; njerëzit të cilët nuk iu bindën Atij, mohuan qenien e Tij dhe adhuruan të tjerët (duke i përshkruar "shokë") pranë Allahut. Kjo ndodh si pasojë e mëshirës së Tij e cila do të përhapet në një masë të papritur në atë ditë dhe kjo është tërësisht në duart dhe vullnetin e Tij. Përsëri një numër i madh përcjelljesh citojnë se mëshira e Allahut, i Lartësuar është Ai, do të jetë r përhapur në Ditën e Ringjalljes deri në atë masë sa dhe shejtani (iblisi) do të presë për të. Kjo do të thotë që dhe iblisi i cili nuk duhet të ketë ndonjë shpresë pasi ai është i dënuar në xhehennem do të kërkojë mëshirën e Allahut duke e ditur se Ai është i Gjithëëshirshmi, Mëshirëploti.

Krahas kësaj dyert e ndërmjetësimit dhe kjo mëshirë e përhapur nuk është e garantuar që të përfshijë secilin nga ne. Besimi dhe veprat e mira do të mbeten garancia e vetme. Vetëm e mira që mbjellim do të korrim atje dhe asgjë tjetër. Veprat tona të mira do të arrijnë para

nesh. E mira që ne japim në këtë botë do të na paraprijë dhe kjo është e vetmja garanci e vërtetë.

Vështrimi Dhe Kapërcimi I Siratit

Pas përmbushjes së këtyre etapave gjithçka do të zgjidhet. Banorët e xhennetit do të mblidhen dhe do të udhëheqin si një dhëndër në dasmën e tyre dhe banorët e xhehennemit do të tërhiqen në zjarrin e xhehennemit nga balluket dhe këmbët e tyre. Të tëra këto imtësi janë të sqaruara në Kur'anin Famëlartë dhe në hadithet fisnike të cilat janë të dobishme për t'u vështuar parë siç është për shembull Sure Zumer.

Këtu do të trajtojmë çështjen e siratit (urës) nëpërmjet së cilës do të kalojmë për të arritur xhennetin - dhe adresimin shkurtimisht të çështjes së fjalës fjalë për fjalë dhe metaforike. A është kjo një urë lëndore e vërtetë përmes së cilës një njeri do të ecë mbi xhehennemin për të arritur xhennetin, apo është një simbol i vetë fesë, e cila është udha e Allahut - sepse siratdo të thotë udha e drejtë -, e cila nëse kalohet do të të çojë në xhennet? Me fjalë të tjera a është përdorimi i fjalës sirat (udha e drejtë) fjalë për fjalë apo metaforike? Dijetarët dhe komentatorët kanë ndasi mendimi në këtë çështje. Disa kanë miratuar mendimin e mëparshëm dhe të tjerët pikëpamjen e dytë. Ky diskutim - pavarësisht se nuk e trajton atë këtu - është me rëndësi të madhe dhe i dobishëm për interesin tonë sepse çështja e siratit është e lidhur ngushtë me fatin dhe banimin e fundit.

Tani ata të cilëdo të hyjnë në xhennet janë fitimtarë dhe lumturia e përjetshme do të jetë vendbanimi i tyre. Sa për ata të cilët do të hyjnë në xhehennem ose do të jetojnë përjetësisht në xhehennem apo do të dalin pas një kohe, si pasojë e shënimit të përzier të veprave të mira dhe të këqija, ose si pasojë e mëshirës së Allahut ose ndërmjetësimit të dikujt. Prandaj ata do të falen dhe do të dërgohen nga xhehennemi në xhennet. Ne nuk do të hyjmë në imtësitë e kësaj çështjeje këtu por kryerja e hulumtimeve dhe kërkimeve është e dobishme. Ajo në të cilën do të përqendrohemi këtu është ndalimi i varësisë nga kjo. Me këtë kemi për qëllim thënien "Epo është gjithçka në rregull. Unë kam bërë vepra të mira dhe të këqija kështu që unë do të hyj në xhehennem për një kohë dhe pastaj do të dal. Megjithatë askush nuk mund të durojë vetëm tymin më të vogël të xhehennemit dhe zjarrin e tij përvëlues. Në këtë pikë skena e ringjalljes merr fund.

Shkurtimisht Mbi Qëllimin E Këtij Kërkimi

Tani na mbetet për të shprehur se qëllimi i gjithçkaje e cila u hulumtua këtu, është të lajmërojmë për papërgjegjësinë dhe pavëmendjen serioze të cilat duhet t'i kemi parasysh të tërë. Kështu secili nga ne duhet të ndjekë një udhë dhe të vendosë një qëllim për veten e tij, në lidhje me të tëra ngjarjet e prekura më lart të cilat do të ndodhin në mënyrë të pashmangshme. Kur'ani Fisnik dhe hadithet e vërteta kanë vërtetuar shfaqjen e ngjarjeve të tilla. Kur të ndodhin, as keqardhja, as pendimi nuk do t'iu sjellin dobi. Sa i keq do të jetë pendimi i njerëzve në atë ditë! Megjithatë qenia i penduar nuk do të ketë asnjë dobi. Mëkatarët do të pendohen për gabimet që kanë kryer pas dëshmisë së dënimit të tmerrshëm. Të drejtët gjithashtu do të pendohen për të metat e tyre pas dëshmisë së shpërblimeve të mëdha. Prandaj duhet të kemi një qëllim të qartë, e cila është arritja e gjendjes së bindjes ndaj Allahut, i Lartësuar është Ai. Megjithatë kjo është ndryshe nga shkallët e ndryshme të bindjes dhe adhurimit, të cilat përfshijnë adhurimin e tregtarëve, adhurimin e robërve dhe adhurimin e njerëzve të lirë. Pra nuk duhet të kufizohet pranimi i Allahut për të arritur hkallën më të lartë të adhurimit. Ky është rasti i të dërguarve dhe i atyre të cilët arritën në shkallët e larta të

shpirtërores. Nuk duhet ta ndërlikojmë çështjen dhe ta bëjmë të vështirë për njerëzit. Si rrjedhojë është më mirë të themi se ne duhet të përpiqemi për të arritur domethënien e vërtetë të bindjes ndaj Allahut në veten tonë, duke iu përmbytur urdhrave të Tij, si dhe duke u ruajtur nga ndalimet e Tij. Allahu me të vërtetë pranon bindjen tonë nëse ne jemi si robër apo tregtarë në adhurimin tonë.

Allahu i Plotfuqishëm thotë: **“Ai i cili del nga zjarri dhe hyn në xhennet ai ka fituar”.** (Sure *Ali Imran*, Ajeti 185)

Ky është një qëllim i dobishëm për një njeri që të kalojë të tërë jetën duke u përpjekur për ta përbushur. Qëllimi i një njeriu duhet të jetë shpëtimi nga xhehennemi, hyrja në xhennet, garantimi i sigurisë dhe lehtësimi në Ditën e Ringjalljes, si dhe fitimi i mëshirës së Allahut. Qëllimi i një njeriu duhet të jetë siguri i imunitetit ndaj zbulimit përpara Allahut, engjëjve të Tij, të dërguarve dhe të tërë njerëzimit. Dikush duhet të dojë të arrijë nderin e përjetshëm, dinjitetin, sigurinë, lumturinë dhe mirëqenien, si dhe shpëtimin nga vuajtja që asnjë shpirt nuk mund ta durojë. Ky duhet të jetë qëllimi ynë. Ne na duhet ta kemi gjithmonë parasysh atë që Allahu na ka kërkuar të bëjmë: **“O ju të cilët keni besuar! Shpëtoni veten tuaj dhe familjet tuaja nga një zjarr, lënda djegëse e të cilit do të jenë njerëzit dhe gurët”.** (Sure *Tahrim*, Ajeti 6)

Nëse duam ta përbushim këtë qëllim, ne do të merremi për arritjen e tij duke vendosur një plan dhe program praktik i cili është i përmblidhur në hapat e mëposhtëm:

Pikë së pari: Ne duhet t’ua kujtojmë vetes për botën tjetër dhe të mos harrojmë kurrë apo ta shpërfillim atë. Ne gjithashtu nuk duhet të kufizojmë kujtimin e ngjarjeve të botës tjetër, të vdekjes, të jetës së varrit, të Ditës së Ringjalljes, të xhennetit dhe xhehennemit vetëm në raste të veçanta, si në Natën e Kadrit (Fatit, Fuqisë, Vlerësimit), ose të vdekjes së një të dashuri. Atë duhet ta kemi parasysh gjatë tërë vitit, sepse vdekja vjen papritur dhe askush nuk e di kur do të vijë koha e saj. Përkujtimi i vazhdueshëm dhe përmendja e vdekjes dhe e botës tjetër janë hapi i parë drejt qëllimit tonë. Kjo është ajo e cila u jep shtysë jetës brenda nesh dhe na bën të vlerësojmë çastet, orët dhe ditët e jetës sonë të cilat mund të përfundojnë në çdo kohë dhe pastaj nuk do të ketë pengesë midis nesh dhe fatit tonë të pashmangshëm.

Pikë së dyti: Duhet të kemi kujdes nga bota tjetër, siç i drejtohet ajeti kuranor përmendur në parathënien. Ajeti na nxit që të marrim këshillë, duke u frikësuar dhe duke pritur botën tjetër duke e patur gjithmonë parasysh dhe vetëm duke vepruar kështu, ne do të kujdesemi për të mbrojtur veten nga të tëra vështirësitë që ajo përmban.

Pikë së treti: Duhet të punojmë për botën tjetër. Në jetën tonë të kësaj bote, ne vendosëm qëllimet për të arritur kështu që ne planifikojmë punojmë shumë dhe përpiqemi ditën dhe natën për t’i përbushur ato. A nuk e meritojnë jetët tona në botën tjetër dhe përpjekjet tona të mëdha dhe punën e madhe? Dikush duhet që së pari të kërkojë faljen e Zotit të tij dhe të pendohet për mëkatet e tij të mëparshme dhe pastaj të kryejë të tëranamazet (salatet) dhe detyrimet të cilat ai ka humbur, të paguajë të zekatin e të varfërve dhe nevojtarëve dhe të përkujojë veten të mos bjerë në tundimin e mëkateve gjatë të tërë kohës. Kjo këshillë i drejtohet veçanërisht brezit të ri, i cili është ende në fillim të jetës së tyre dhe plot gjallëri dhe energji të cilat mungojnë tek brezat e vjetër. Kjo megjithatë nuk do të thotë se të tjerët kanë humbur shanset e tyre. Kjo do të thotë vetëm se të rinjtë kanë mundësi më të mëdha. Të tërë duhet të bëjmë mirë dhe të përfitojmë nga qenia jonë në këtë jetë. Ne duhet të përdorim atë që na ka mbetur nga shëndeti, energjia, paraja, fuqia dhe koha. Ne duhet t’i kushtojmë asaj që na

ka mbetur nga jeta jonë për të ndërtuar një jetë të mirë në botën tjetër, e cila nuk do të zgjasë pesëdhjetë apo njëqind vjet, por vite të pafundme në vendbanimin e përjetshëm.

Intësitë më tërëndësishme në këtë program janë përmbajtur nga çdo shtojcë në këtë botë të zakonshme, duke përfshirë pasurinë, fuqinë dhe dëshirat. Për lidhjen tonë me të na lejon të gjejmë të lehtë kryerjen e veprave të ndaluara për të përmbushur dëshirat tona të kësaj bote. Shumë nga ata janë ata të cilët kërkonin një dëshirë ose epsh të kësaj bote i cili i nxiti ata që të kryenin mëkate për ta përmbushur atë. Pavarësisht kësaj nuk nënkuptojmë që njerëzit duhet t'u japin fund të tëra çështjeve të tyre të kësaj bote, sepse kjo jetë është një fushë për t'u mbjellë për botën tjetër. Njerëzit kanë gra, fëmijë dhe përfitime në këtë botë. Ajo që kërkohet nga ata është që të mos bashkohen me të deri në masën që ata të hedhin poshtë dhe të ofrojnë shërbimet e tyre, paratë ose djemtë (për një qëllim më të lartë) ose të jenë të pranishëm kur nevojiten në fushën e xhihadit. Të lësh këtë botë do të thotë të kesh një zemër e cila dëshiron botën tjetër. Njerëzve u kërkohet që të përfitojnë nga kjo botë dhe të jetojnë si të përkushtuarit. Ky është thelbi i udhëtimit të Imam Husejnit (p.m.t.) së bashku me shokët e tij në Kerbela.

Beteja E Kerbelasë Dhe Udhëtimi Në Botën Tjetër

Në të njëjtin kontekst është e sigurtë të thuhet se disa njerëz mund të kenë sukses në ndjekjen e shpëtimit nga xhehennemi dhe në hyrjen në xhennet, ndërsa të tjerët madje mund të arrijnë shkallë më të larta dhe suksese më të mëdha të cilat mund të çojnë në shpëtimin e të tjerëve gjithashtu. Sidoqoftë përpjekja më e madhe është të përpiqemi që të sigurojmë shpëtim për të tërë njerëzit në tokë. Kjo ishte detyra e të dërguarve dhe e imamëve (p.m.t.), si dhe kjo ishte detyra e Imam Husejnit (p.m.t.). Në Kerbela përmes revolucionit të tij dhe rënies së tij dëshmor në mënyrë të bekuar, Imam Husejni (p.m.t.) donte që t'i çonte njerëzit larg udhës së xhehennemit dhe u ofroi atyre një derë për në xhennet, e cila do të mbetet e hapur derisa të vijë Ora. Cili është thelbi i Betejës së Kerbelasë?

Kur flasim për këtë fatkeqësi nuk po flasim për një shoqëri e cila nuk ka dalluar të drejtën nga e gabuara. E vërteta ishte e qartë ashtu siç ishte e qartë dhe gënjeshtër. Të tërë muslimanët gjatë asaj epoke e dinin se kush ishte Imam Husejni (p.m.t.) dhe gjithashtu e njihnin Jezidin. Imam Husejni (p.m.t.) njihej si nipi i të dërguarit të Allahut (p.q.m.t.), me një qëndrim të lartë dhe një vend të nderuar të cilat nuk mund të mohohen nga askush.

Si rrjedhojë theksojmë se e vërteta, gënjeshtër, beteja dhe qëllimet ishin të qarta. Duke përshkruar ngjarjet, mund të themi se një palë njerëzish u mbërthyen në këtë botë të zakonshme dhe kishin frikë për pronat, familjet, shtëpitë dhe pjesën tjetër të jetës së tyre që i priste, kështu që ata tradhtuan nipin e të dërguarit të Allahut (p.q.m.t.) dhe e vranë brutalisht atë. Disa prej tyre e bënë këtë për hir të fitimit të pozitës së pushtetit në Raj, Kufe ose Basra. Ata tradhtuan dhe vranë Imam Husejnin (p.m.t.) dhe kështu humbën jetën e tyre (të përjetshme) në botën tjetër. Ata ishin të turpëruar (nga Allahu) në këtë botë dhe nuk arritën asgjë nga shpërblimet për të cilat ata luftuan. Nga ana tjetër ishin disa njerëz - të cilët ishin më të paktë në numër - të cilët me të vërtetë e njihnin Allahun dhe qëndronin me frikë përpara Imam Husejnit (p.m.t.) kur u thirrën, si Habib Ibn Mudhahiri, i cili ishte një burrë i moshuar, si dhe Zuhejr Ibn Kajni, Abbas Ibn Aliu, i riu Kasimi sidhe burrat dhe gratë e mbetura të cilët ishin të pranishëm atje në Kerbela.

Çfarë U Shkoi Në Mendje Këtyre Njerëzve Siç Vijon

Kur të vijë koha dhe ne jemi mbledhur në shkretëtirën e ringjalljes përpara Allahut të Plotfuqishëm dhe kur do të merremi në pyetje për kryengritjen e Imam Husejnit (p.m.t.), nipit të të dërguarit të Allahut (p.q.m.t.), e cila është bërë për hir të mbrojtjes së fesë sonë, nxitjen e virtytit dhe parandalimin e vesit; kur do të merremi në pyetje dhe për detyrimin për ta mbrojtur atë dhe për t'iu përgjigjur thirrjes së tij dhe nëse kemi luftuar me flamurin e tij apo jo; përgjigja jonë do të jetë: “Po! Ne e bëmë O Zot! Ne qëndruam pranë tij, qëndruam të palëkundur, ndamë etjen tonë me të, luftuam pranë tij dhe vdiqëm në krahët e tij, kështu që ne do të ngriheshim në Ditën e Ringjalljes me fytyra të bardha e të ndriçuara - në ditën kur disa fytyra do të shndërrohen në të ndriçuara dhe të tjeranë të errëta.

Kjo Është Historia E Kerbelasë Në Thellësi Dhe Në Të Vërtetë

Paqja e Allahut qoftë mbi ty, zotëriu im Ebu Abdullah Husejni, o biri i të dërguarit të Allahut (p.q.m.t.) dhe mbi shpirtrat të cilët erdhën në ushtrinë tënde për t'u bashkangjitur. Me ju, nga unë, është paqja e Allahut për përjetësinë, për sa kohë që natën dhe ditën të mbetet dhe kjo vizitë nuk do të jetë kontakti im i fundit me ju. Përshëndetja qoftë mbi Husejnin, mbi Aliun, të birin e Husejnit, mbi fëmijët e Husejnit dhe mbi shokët e Husejnit.

Dhe i tërë falenderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të tëra botërave.

Një Seri Mësimesh

Nga Sejjid Hasan Nasrullahu

Shkretëria E Ringjalljes

Qëllimi i një njeriu duhet të jetë shpëtimi nga xhehennemi, pranimi në xhennet, garantimi i sigurisë, lehtësimi në Ditën e Ringjalljes dhe mëshira e Allahut!